

Mr. Rejhan Neziri

ISLAMI IM

Shkalla II

Për fëmijë të moshës 13 – 16 vjeçe (klasa 5 – 8)

Kreuzlingen, 2015

Përmbajtja:

Mësimi 1: XHAMIA	5
Mësimi 2: PSE MUSLIMANËT SHKOJNË NË XHAMI?	6
Mësimi 3: NË ÇKA BESOJNË NJERËZIT QË SHKOJNË NË XHAMI?	7
Mësimi 4: EMRAT E BUKUR TË ALL-LLAHUT XH.SH.	8
Mësimi 5: CILËSITË E ALL-LLAHUT XH.SH.	9
Mësimi 6: BESIMI NË MELEKËT E ZOTIT	10
Mësimi 7: XHINET DHE SHEJTANI	11
Mësimi 8: BESIMI NË LIBRAT E ZOTIT	12
Mësimi 9: KUR’ANI FISNIK	13
Mësimi 10: BESIMI NË PEJGAMBERËT E ZOTIT	14
Mësimi 11: KUSH ËSHTË MUHAMMEDI A. S. – 1 ?	15
Mësimi 12: KUSH ËSHTË MUHAMMEDI A. S. – 2 ?	16
Mësimi 13: MORALI I MUHAMMEDIT A. S.	17
Mësimi 14: BESIMI NË DITËN E KIJAMETIT (AHIRETIT)	18
Mësimi 15: XHENNETI DHE XHEHENNEMI	19
Mësimi 16: BESIMI NË KADERIN DHE KADANË E ZOTIT	20
Mësimi 17: LITARI DHE GURI	21
Mësimi 18: NETËT DHE DITËT E MIRA (TË MËDHA)	22
Mësimi 19: IBADETI NË ISLAM	23
Mësimi 20: PUNËT E MUSLIMANIT	24
Mësimi 21: SHEHADETI	25
Mësimi 22: PASTËRTIA NË ISLAM	26
Mësimi 23: ABDESTI DHE TEJEMMUMI	27
Mësimi 24: GUSLI	28
Mësimi 25: NAMAZI DHE RËNDËSIA E TIJ NË ISLAM	29
Mësimi 26: PARAKUSHTET E NAMAZIT	30
Mësimi 27: PJESËT E BRENDSHME TË NAMAZIT	31
Mësimi 28: AGJËRIMI I RAMAZANIT	32
Mësimi 29: RAMAZANI DHE AGJËRIMI	33
Mësimi 30: ZEKATI	34
Mësimi 31: HAXHI	35
Mësimi 32: BAJRAMI I KURBANIT	36
Mësimi 33: TRI KËSHILLAT E BILBILIT	41
Mësimi 34: MORALI ISLAM	37
Mësimi 35: DETYRAT TONA NDAJ ZOTIT	43
Mësimi 36: DETYRAT TONA NDAJ PRINDËRVE	38
Mësimi 37: DJALOSHI DHE DRURI I MOLLËS	39
Mësimi 38: DETYRAT TONA NDAJ NJERËZVE TË TJERË	40
Mësimi 39: JETA	41
Mësimi 40: NE DHE KRIJESAT TJERA TË ZOTIT	44

Mësimi 1

XHAMIA

Xhamia është një ndërtesë ku i falemi All-llahut të Madhërishëm.

Xhamia nga ana e djathtë e ka minaren, që është e hollë dhe mjaft e lartë. Aty kah mbarimi i trupit të minares ndodhet ballkoni të cilin e quajmë “sherife” dhe në të cilin hipën muezini për ta thirrur ezanin. Kohëve të fundit ezani jepet me altoparlantë, të cilët janë të ngjitur në minare.



Kur hyjmë në xhami, në anën e përparme të saj shohim një skutë që i ngjan oxhakut të vatrës. Ky vend quhet “mihrab”. Aty falet hoxha (imami). Në anën e djathtë të mihrabit ndodhen disa shkallë ku hoxha hipën ditëve të premtë dhe atje mban një fjalim i cili quhet “hutbe”. Këto shkallë, që në disa xhami janë 10 e në disa më pak ose më tepër, quhen “minber”. Në anën e majtë të mihrabit ndodhet selia e hoxhës e cila quhet “kursijj”. Në kursijj hoxha hipën ditëve të premtë para namazit të xhumasë, ditëve të Bajramit etj. dhe mban ders (ligjëratë fetare).

Në xhami nuk hyhet me këpucë, sepse ajo është e shtruar me tepihë dhe duhet të mbahet e pastër. Edhe ata që hyjnë në xhami duhet të jenë të pastër, si në veshmbathje ashtu edhe në trup. Ata duhet të pastrohen në banjë ose të marrin abdest, e pastaj të hyjnë në xhami. Atyre nuk duhet t’u vijë era e qepës ose e hudhrës nga goja, as era djersë, as era e çorapëve dhe e këmbëve. Është mirë të parfumohen me aroma të mira. Në xhami nuk duhet të bisedohet shumë. Në xhami ne më tepër i lutemi Zotit, prandaj edhe quhet “Shtëpia e Zotit”.

Detyrë shtëpie:

1. Çka është xhamia dhe çka bëjmë në të?
2. Çka është minarja, cilat janë pjesët e saj dhe për se shërben?
3. Çka quajmë “mihrab” dhe për çka shërben?
4. Ç’është “minberi” dhe për çka duhet?
5. Ç’është “kursijja” dhe për çka shërben?
6. Pse nuk hyhet me këpucë brenda në xhami?
7. Si duhet të jenë ata që hyjnë në xhami?

Mësimi 2

PSE MUSLIMANËT SHKOJNË NË XHAMI?

Muslimanët dhe muslimanet duhet ta falënderojnë Zotin e Madhëruar për të mirat e shumta që ua ka dhuruar, si p.sh.: jetën, shëndetin, ushqimet e ndryshme, familjen, fenë etj. Muslimani këtë falënderim e tregon duke e lartësuar, duke iu lutur dhe falur të Madhit Zot. Muslimanët mund t'i luten Zotit në çdo vend, me kusht që ky vend të jetë i pastër. Por, falja në xhami me xhemat (bashkësi) është më e vlefshme dhe më e pëlqyeshme.

Nga falja e namazit në xhami kemi shumë dobi. Së pari, aty gjejmë një grup shokësh me të cilët, duke u parë më shpesh, njihemi më mirë dhe na shtohet dashuria më shumë.

Në xhami i gjejmë njerëzit më të mirë. Njerëzit e xhamisë i dëgjojnë më shpesh urdhrat e Zotit dhe të Pejgamberit a.s.. Pra janë njerëz të urtë e të sjellshëm. Ata nuk janë alkoolistë, nuk luajnë bixhoz (kumar) dhe nuk bëjnë punë të tjera të liga.

Ata të cilët shkojnë në xhami, mësohen të jenë më të disiplinuar, sepse në xhami do të falen së bashku pas një imami, e kjo gjë i stërvit në rregull dhe disiplinë.

Përveç këtyre, në xhami shpeshherë organizohen edhe derse dhe këshilla, me të cilat na zbutet zemra, na kënaqet shpirti, na shtohet kultura fetare, shoqërore e morale dhe kështu vazhdimisht përmirësohen sjelljet tona.

Më në fund, në xhami e dëgjojmë fjalën e Zotit që është Kur'ani, të cilin e këndon imami i xhamisë me zë të bukur. Kur'ani është ushqimi më i mirë, më i ëmbël dhe më i dobishëm i shpirtit.

Ai që dëshiron të kënaqet me këto të mira të xhamisë, duhet të shkojë rregullisht në xhami, sidomos ditëve të xhumaja, të bajrameve e të festave të tjera fetare.

Detyrë shtëpie:

1. Pse muslimani duhet ta falënderojë e t'i lutet Zotit?
2. Ku i luten All-llahut muslimanët?
3. Pse është më e vlefshëm namazi në xhami?
4. Pse njerëzit që shkojnë në xhami janë më të mirë?
5. Pse njerëzit që shkojnë në xhami janë më të disiplinuar?
6. Si i përmirëson xhamia sjelljet tona?
7. Pse na kënaq leximi i Kur'anit?

Mësimi 3

NË ÇKA BESOJNË NJERËZIT QË SHKOJNË NË XHAMI?



Të gjithë ata që shkojnë në xhami, kanë një besim dhe një qëllim. Ata besojnë në një Zot të vërtetë dhe të gjithë i luten njësoj. Ata që shkojnë në xhami edhe punët e veprimet i kanë të njëjta. Për të parë se vërtet i kanë të njëjta veprimet dhe punët, duhet të shkojmë në xhami edhe ne, pasi që aty mund të shohim çka bëjnë dhe si luten muslimanët.

Besimi i parë i cili i bashkon muslimanët është “Besimi në një Zot të Vërtetë dhe të Përhershëm”.

Zoti i Vërtetë dhe i Përhershëm është vetëm Një, i Cili ka ekzistuar, ekziston dhe do të ekzistojë gjithnjë. Zoti e ka krijuar gjithësinë dhe çdo gjë tjetër. Pra, Zoti ka ekzistuar edhe kur nuk kanë ekzistuar gjithësia dhe njerëzia. Zoti ka ekzistuar vetvetiu e nuk është i krijuar apo i lindur.

Themi Zot i vërtetë për ta rrënuar besimin e gabueshëm të atyre që besojnë në zota të rrejshëm. Në botë ka njerëz që besojnë se idhujt janë zota; ka të tjerë që zjarrin e besojnë si zot; ka të atillë që diellin e besojnë për zot, por edhe të atillë që pejgamberin e tyre e kanë shndërruar në Zot.

Vetëm Zoti krijon çdo gjë dhe ka fuqi të plotë e të pakufishme.

Siç shihet, muslimanët bashkohen në besimin dhe në madhërimin e Zotit të Vërtetë të quajtur All-llah, prandaj janë vëllezër të një feje.

Detyrë shtëpie:

1. Çka kanë të përbashkët njerëzit që shkojnë në xhami?
2. Si mund t'i kuptojmë punët dhe veprimet e muslimanëve?
3. Cili është besimi i parë që i bashkon muslimanët?
4. Sa zota ka dhe kur ka lindur Zoti?
5. Si e quajnë muslimanët Zotin dhe çka ka krijuar Ai?
6. Cilët janë zota të rrejshëm?

Mësimi 4

EMRAT E BUKUR TË ALL-LLAHUT XH.SH.

Sipas Kur'anit, All-llahu xh.sh. ka emrat e Tij të bukur, me të cilët Ai e përshkruan Vetveten. Për ta kuptuar më mirë se kush është Zoti dhe çfarë bën Ai, për këtë na ndihmojnë emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij.

Muhammedi a.s. ka thënë: *“All-llahu ka 99 emra. Kush i mëson ato përmendsh (dhe jeton me kuptimin e tyre) do të hyjë në Xhennet.”*

Emrat e bukur të All-llahut xh.sh. janë:

- | | | |
|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| 1. All-llahu | 34. Madhështori | 67. I Vetmi |
| 2. I Gjithëmëshirshmi | 35. Falësi | 68. Strehimtari |
| 3. Mëshirëploti | 36. Mirënjohësi | 69. I Fuqishmi |
| 4. Sunduesi | 37. I Larti | 70. I Gjithëmundshmi |
| 5. I Shenjti | 38. I Madhi | 71. Nismëtari |
| 6. Paqedhënësi | 39. Ruajtësi | 72. Paslënësi |
| 7. Siguruesi | 40. Ushqyesi | 73. I Pari |
| 8. Mbizotëruesi | 41. Llogarimarrësi | 74. I Fundit |
| 9. Fuqploti | 42. Fisniku | 75. I Dukshmi |
| 10. I Gjithëfuqishmi | 43. Bujari | 76. I Padukshmi |
| 11. I Madhërishmi | 44. Vigjëluesi | 77. Udhëheqësi |
| 12. Krijuesi | 45. Lutjepranuesi | 78. I Gjithëlartësuar |
| 13. Filluesi | 46. Gjithëpërfshirësi | 79. Mirëbërësi |
| 14. Formëdhënësi | 47. I Urti | 80. Pendimpranuesi |
| 15. Gjithëfalësi | 48. I Dashuri | 81. Ndëshkuesi |
| 16. Mposhtësi | 49. I Lavdishmi | 82. Mëkatfalësi |
| 17. Dhuruesi | 50. Ringjallësi | 83. I Dhembshuri |
| 18. Furnizuesi | 51. Dëshmuesi | 84. Pushtetmbajtësi |
| 19. Zgjidhjedhënësi | 52. I Vërteti | 85. I Vetmi absolut |
| 20. I Gjithëdituri | 53. Përkujdesësi | 86. Drejtësidhënësi |
| 21. Shtrënguesi | 54. I Forti | 87. Tubuesi |
| 22. Dhënësi | 55. I Pathyeshmi | 88. I Pasuri |
| 23. Përrulësi | 56. Mbrojtësi | 89. Pasuruesi |
| 24. Lartësuesi | 57. I Falënderuari | 90. Privuesi |
| 25. Ngritësi | 58. Gjithënjohësi | 91. Dëmsjellësi |
| 26. Nënshtruesi | 59. Nismëtari | 92. Dobiprurësi |
| 27. Dëgjuesi | 60. Rikrijuesi | 93. Drita |
| 28. Vështruesi | 61. Jetëdhënësi | 94. Udhëzuesi |
| 29. Gjykuesi | 62. Jetëmarrësi | 95. Shpikësi |
| 30. I Drejti | 63. I Gjalli | 96. I Përhershmi |
| 31. I Buti | 64. I Përjetshmi | 97. Trashëguesi |
| 32. I Gjithinformuari | 65. Krijuesi | 98. Frymëzuesi |
| 33. Përdëllimtari | 66. I Nderuari | 99. Durimtari |

Detyrë shtëpie: Shkruaji 15 emra të bukur të All-llahut që ty të pëlqejnë më së shumti.

Mësimi 5

CILËSITË E ALL-LLAHUT XH.SH.

All-llahu xh.sh. ka edhe cilësitë apo vetitë e Tij, për ta njohur Atë më mirë se kush është Ai dhe çfarë bën.

Cilësitë e tij ndahen në:


- A. *Dhatijje*, që kanë të bëjnë me qenien e Tij dhe këto cilësi i ka vetëm Ai,
- B. *Thubutijjeh*, që kanë të bëjnë me veprimet e Tij të pakufishme.

A. Cilësitë *dhatijje* të Zotit janë:

1. Vuxhud – All-llahu xh. sh. Ekziston,
2. Kidem – Ai s’ka fillim,
3. Beka – Ai s’ka mbarim,
4. Vahdaniijeh – Ai është Një i Vetëm,
5. Muhalefetun lil-havadith – Ai nuk i përngjan askujt dhe asgjëje,
6. Kijam bi nefsih – Ai jeton i pavarur.

B. Cilësitë *thubutijje* të Zotit janë:

1. Hajah – Ai jeton
2. Ilm – Ai di gjithçka
3. Sem’ – Ai dëgjon gjithçka
4. Besar – Ai sheh gjithçka
5. Iradeh – Ai ka vullnet të pakufishëm
6. Kudret – Ai ka fuqi të pakufishme
7. Kelam – Ai flet me engjëj e me pejgamberë
8. Tekvin – Ai krijon gjithçka



Detyrë shtëpie:

1. Si ndahen cilësitë e Zotit?
2. Cilat janë cilësitë dhatijje të Zotit?
3. Cilat janë cilësitë thubutijje të Zotit?

Mësimi 6

BESIMI NË MELEKËT E ZOTIT

Një prej kushteve të besimit islam është edhe besimi në melekët (melaqet) apo engjëjt e Zotit.

All-llahu xh.sh. Melekët i ka krijuar nga nuri (drita). Ata nuk kanë gjini pra s'ka melek mashkull apo melek femër.

Melekët nuk hanë, nuk pinë, nuk martohen dhe nuk shumëzohen.

Ata nuk gabojnë dhe nuk bëjnë mëkat. Ato janë të dëgjueshme ndaj Zotit. Çka do që t'i urdhërojë Zoti, ato e kryejnë atë pa vonesë.

Ekzistojnë katër melekë më të mëdhenj: Xhebraili, Mikaili, Azraili dhe Israfil.

Xhebraili (Xhibrili): është meleku i cili fjalët dhe librat e Zotit ua shpall peygamberëve.

Mikaili: është meleku i cili kujdeset për ngjarjet në natyrë, si: shiu, bora, tërmeti, rritja e bimëve etj.

Azraili (Meleku i vdekjes): është meleku i cili është i obliguar t'i marrë shpirtrat e gjallesave, kur atyre u vjen exheli (afati) për të vdekur.

Israfil: i frynë surit (bririt) dhe njofton për Ditën e Kijametit dhe të Ringjalljes.

Ekzistojnë edhe melekë të tjerë, si për shembull:

Melekët **Hafedhah** (mbrojtës). Këta melekë i mbrojnë njerëzit e mirë, e sidomos fëmijët, nga rreziqe të ndryshme.

Melekët **Kiramen katibin**: e kanë për detyrë t'i shënojnë veprat tona të mira dhe të këqija. Meleku që ndodhet në anën tonë të djathtë i shënon veprat dhe fjalët tona të mira, kurse meleku që ndodhet në anën tonë të majtë i shënon veprat dhe fjalët tona të këqija.

Melekët **Munker dhe Nekir**: janë dy melekë që do t'i marrin në pyetje njerëzit kur ata të hyjnë në varr. Ata i pyesin se kush është Zoti i tyre, peygamberi i tyre, libri i tyre i shenjtë etj.

Melekët **Hazene**: janë melekët që e kanë për detyrë të merren me banorët e Xhennetit dhe të Xhehennemit.

Numrin e saktë të melekëve e di vetëm All-llahu xh.sh. Ato luten për njerëzit e mirë dhe i motivojnë njerëzit të bëjnë punë të mira.

Detyrë shtëpie:

1. Nga se janë krijuar melekët dhe çfarë krijesash janë ata?
2. Shëno, cilët janë 4 melekët e mëdhenj dhe çfarë detyrash kanë?
3. Çfarë detyre kanë melekët Kiramen katibin?
4. Çfarë bëjnë melekët për njerëzit e mirë?

Mësimi 7

XHINDET DHE SHEJTANI

Xhindet (exhinet, xhinnët) janë qenie të krijuara nga zjarri dhe janë të padukshme për njerëzit.

Xhindet, sikurse edhe njerëzit, hanë, pinë, martohen dhe shumëzohen, pasi ato kanë edhe gjini, mashkull-femër. Ato lindin, rriten dhe vdesin.

Xhindet mund të marrin forma të ndryshme dhe kanë aftësi të kryejnë punë të mëdha e të rënda. Ato janë shumë të shpejta në lëvizjet e tyre.

Ato nuk e dinë të fshehtën dhe të ardhmen. Mirëpo, dinë shumë më shumë se njerëzit, pasi që ato shohin dhe dëgjojnë gjëra që njeriu nuk i sheh dhe nuk i dëgjon.

Edhe xhindet, sikurse njerëzit, janë të obliguara të ndjekin fjalët e All-llahut xh.sh. dhe t'i kryejnë detyrat e tyre fetare. Prandaj ka xhinde besimtare dhe jobesimtare. Për këtë arsye edhe ato do të përgjigjen në botën tjetër për punët e tyre dhe varësisht sipas tyre do të shpërblehen me Xhennet ose do të dënohen me Xhehennem.

Muhammedi a.s. ka qenë pejgamber edhe për njerëzit po edhe për xhindet.

Shejtani (djalli, dreqi) është një xhind i cili në fillim ishte shumë i dëgjueshëm ndaj Zotit, mirëpo më vonë rebelohet ndaj Tij dhe nuk i respekton urdhrat e Tij.

Kur Zoti e krijoi Ademin a.s., u tha melekëve dhe xhindeve që ta përshëndesnin Ademin a.s. me përkulje dhe sexhde. Shejtani (Iblisi) e kundërshtoi këtë urdhër të Zotit duke thënë: “Unë jam më i mirë se ai, mua o Zot më ke krijuar nga zjarri, kurse Ademin e ke krijuar nga dheu”. Për këtë mosdëgjim të tij Zoti e përzu shejtanin nga mëshira e Tij dhe e mallkoi. Pastaj shejtani u zotua se Ademin dhe të gjithë njerëzit e tjerë do të mundohet t'i largojë nga rruga e Zotit dhe se do t'i motivojë të bëjnë punë të këqija.

Shejtani mundohet t'i ngatërroje njerëzit dhe të mbjelle hidhërimin dhe urrejtjen midis tyre. Ai mundohet ta largojë njeriun nga namazi, nga leximi i Kur'anit, nga përmendja e All-llahut xh.sh. etj.

Kur'ani i quan shejtan edhe njerëzit e këqij të cilët bëjnë punë të këqija si të shejtanit.

Shejtani nuk mund të ketë ndikim te muslimanët e mirë e të devotshëm. Ata i mbron All-llahu xh.sh. dhe melekët.

Detyrë shtëpie:

1. Çfarë janë xhindet dhe çfarë pune bëjnë ata?
2. Çfarë është shejtani dhe çfarë pune bën ai?

Mësimi 8

BESIMI NË LIBRAT E ZOTIT

Një prej bazave të besimit islam është edhe besimi në librat (qitabet) e Zotit. Për t'ua mësuar njerëzve të vërtetën dhe për t'i larguar nga e pavërteta, përmes peygamberëve Zoti ka dërguar disa libra. Këta libra quhen “libra të shenjtë”. Këta ndahen në tri grupe:

1. Libra që janë zhdukur tërësisht
2. Libra që një pjesë e tyre është shtrembëruar
3. Libra që janë ruajtur në origjinal.



Në **grupin e parë** bëjnë pjesë “suhufet” (broshurat). Asnjëra prej tyre sot nuk ekziston. Kur’ani na njofton se Zoti disa prej këtyre ua ka dërguar disa peygamberëve, si p.sh. Ibrahimit dhe Musait a.s. Po ashtu ka njoftime se broshura të këtilla kanë pasur edhe Ademi, Shiti dhe Idrisi a.s.

Në **grupin e dytë** bëjnë pjesë librat që janë shpallë nga Zoti, mirëpo që më vonë janë ndryshuar nga ana e njerëzve. Prandaj edhe sot nuk ekziston origjinali i tyre. Ne si muslimanë besojmë se Zoti këta libra ua ka shpallë disa peygamberëve të Tij. Këta libra janë: Tevrati (Tora) i është shpallur Musait a.s., Zeburi (Psalmet) Davudit a.s. dhe Inxhili (Ungjilli, Bibla) Isait a.s.


Në **grupin e tretë** bën pjesë vetëm Kur’ani. Kur’ani është libri i fundit që All-llahu xh.sh. ia ka shpallur mbarë njerëzimit nëpërmjet melekut Xhibril deri te peygamberi i fundit Muhammedi a.s. Ai është ruajtur deri më sot pa asnjëfarë ndryshimi apo shtrembërimi dhe i këtillë do të ruhet deri në Kijamet. Këtë e ka garantuar vetë All-llahu xh.sh. Komplet Kur’anin sot me mijëra e mijëra muslimanë në botë e dinë përmendsh. Ka edhe shumë fëmijë, nga moshë 5 vjeçare e më lartë, që e kanë mësuar Kur’anin përmendsh.

Detyrë shtëpie:

1. Pse ka dërguar libra Zoti?
2. Si ndahen librat e shpallur të Zotit?
3. Cilët libra bëjnë pjesë në grupin e parë?
4. Cilët libra bëjnë pjesë në grupin e dytë?
5. Cilët libra bëjnë pjesë në grupin e tretë?

Mësimi 9

KUR'ANI FISNIK



Kur'ani është një libër në të cilin janë të shkruara fjalët e Zotit, që meleku Xhebrail ia ka shpallur Pejgamberit të fundit të dërguar nga Zoti, Muhammedit a.s.

Kur'ani ka filluar t'i shpallet Muhammedit a.s. në vitin 610 dhe ka mbaruar në vitin 633, pra shpallja e Kur'anit ka zgjatur gjithsej 23 vjet. Ndonjëherë janë shpallur nga disa ajete, e ndonjëherë edhe nga një sure e tërë.

Sa herë që meleku Xhebrail i shpallte ndonjë ajet apo sure Muhammedit a.s., ai ua tregonte shokëve të vet të cilët edhe e mësonin përmendsh atë po edhe e shkruanin nëpër sende të ndryshme, si në lëkurë kafshe, në eshtra të vjetër, në kaktuse etj., pasi akoma nuk ishte e zbuluar letra. Pejgamberi a.s. kishte caktuar disa njerëz si sekretarë të tij dhe ata e kishin për detyrë ta shkruanin atë që ia shpallte meleku. Kështu është mundësuar që Kur'ani të ruhet në

tërësi ashtu siç e ka shpallur meleku Xhibril nga ana e All-llahut xh.sh.

Kur'ani ka gjithsej 600 faqe, 30 xhuza, secili xhuz ka nga 20 faqe. Kur'ani ndahet në njësi të quajtura sure (kaptina), ai ka 114 sure, të cilat janë të përfshira në krejt ato 600 faqe dhe secila prej tyre ka emrin e vet. Secila sure ka nga disa ajete (vargje), numrat e të cilave janë shënuar në fund të tyre. Sureja më e gjatë e Kur'anit është el-Bekara që ka 286 ajete, kurse sureja më e shkurtër është el-Kevther që ka vetëm 3 ajete. Sureja e parë është el-Fatiha, kurse e fundit është en-Nas. Krejt Kur'ani ka 6236 ajete.

Kur'ani është shpallur në gjuhën arabe, sepse vetë Muhammedi a.s. ishte arab, mirëpo sot Kur'ani është përkthyer në mbi 100 gjuhë të botës edhe atë nga disa herë, për shembull vetëm në gjuhën shqipe sot ka 5 përkthime të Kur'anit.

Personi i cili e mëson krejt Kur'anin përmendsh quhet *hafidh* (hafiz).

Detyrë shtëpie:

1. Ç'është Kur'ani?
2. Kur është shpallur Kur'ani?
3. Prej çka përbëhet Kur'ani? Sa faqe, xhuza, sure dhe ajete ka ai?
4. Në cilën gjuhë është shpallur Kur'ani?
5. Çka quajmë "hafidh"?

Mësimi 10**BESIMI NË PEJGAMBERËT E ZOTIT**

Pejgamberët janë njerëz sikurse ne, të cilët Zoti i ka zgjedhur me qëllim që ata t'ua përcjellin e t'ua sqarojnë njerëzve urdhrat dhe ndalesat e Zotit. Njeriu nuk mund të bëhet pejgamber vetvetiu duke punuar për të, porse pejgamberin e zgjedh vetë Zoti. All-llahu xh.sh. e zgjedh një person dhe atij ia dërgon melekun Xhibril i cili e njofton se ai do të jetë pejgamber dhe pastaj kohë pas kohe ia shpall fjalët e Zotit që pejgamberi pastaj t'ua tregojë dhe shpjegojë ato njerëzve të tjerë.

Sipas një hadithi të Muhammedit a.s. Zoti ka dërguar 124'000 pejgamberë përpara tij dhe se ky është pejgamberi i fundit. Kurse në Kur'an përmenden me emër vetëm 28 pejgamberë, e ata janë: Adem, Idris, Nuh, Hud, Salih, Ibrahim, Lut, Ismail, Is'hak, Jakub, Jusuf, Davud, Sulejman, Shuajb, Musa, Harun, Ejjub, Junus, Iljas, Eljesa, Dhulkifl, Dhulkarnejn, Lukman, Uzejr, Jahja, Zekerijja, Isa dhe Muhammed s.a. Për Dhulkiflin, Dhulkarnejnin dhe Lukmanin dijetarët islamë mendojnë se mund të mos kenë qenë pejgamberë, porse vetëm njerëz të mirë.

Prej të gjithë pejgamberëve, 5 janë më të dalluar te Zoti, e ata janë: Nuhi, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhammedi a.s.

Pejgamberët kanë qenë njerëz sikurse ne, kanë hëngër, kanë pi, janë martuar etj. Për dallim prej nesh ata kanë pasur disa cilësi dhe veçanti, e ato janë:

1. **Sidk** – i drejtë. Të gjithë pejgamberët e Zotit kanë qenë të drejtë dhe kurrë nuk kanë rrejtur apo mashtruar dikë.
2. **Emanet** – i besueshëm. Të gjithë pejgamberët e Zotit kanë qenë të besueshëm e besnikë dhe atë çka ua ka shpallur Zoti, ata ua kanë përcjellë me ndershmëri njerëzve të tyre.
3. **Fetanet** – i mençur. Të gjithë pejgamberët e Zotit kanë qenë shumë të mençur, të ditur e të urtë.
4. **Ismet** – pa mëkate. Asnjë pejgamber i Zotit nuk ka bërë ndonjë mëkat apo gjynah. Ata kanë vepruar ashtu si i ka porositur Zoti.
5. **Tebliğ** – përcjellës. Detyra e çdo pejgamberi ka qenë që ato fjalë të Zotit që ia sjell meleku Xhibril, pa i shtuar dhe pa i pakësuar t'ua përcjellë njerëzve. Pejgamberët nuk e kanë pasur për obligim që njerëzit me zor e me fuqi t'i detyrojnë të besojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Çka janë pejgamberët e Zotit?
2. Sa pejgamber ka pasur dhe cilët përmenden në Kur'an?
3. Cilët janë pejgamberët më të dalluar?
4. Cilat janë cilësitë e pejgamberëve?

Mësimi 11

KUSH ËSHTË MUHAMMEDI A. S. ?

Muhammedi alejhis-selam (paqa e Zotit qoftë mbi të!) është pasardhës i Beni Hashimitëve, prej fisit Kurejsh. Ai është lindur në qytetin Mekke të Arabisë Saudite në vitin 570/571.

Babai i tij është quajtur Abdullah, kurse nëna e tij Emine. Babai i vdes dy muaj para se të lindte Muhammedi a.s., kurse nëna i vdes kur ky kishte gjashtë vjet. Katër vitet e para Muhammedi a.s. i kalon në një fshat të Mekkes, në shtëpinë e Halimes. Halimja ishte gruaja e cila e rriti dhe u kujdes për të, prandaj ajo quhet edhe nëna e Muhammedit a.s. për qumështi, pasi ajo i kishte dhënë edhe gji të pinte si i vogël që ishte.

Pastaj për të kujdeset gjyshi i tij Abdulmuttalibi, i cili vdes kur ky i kishte tetë vjet. Kurse pas vdekjes së gjyshit atë e merr nën mbrojtje xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Muhammedi a.s. derisa ishte te mixha i vet, i kulloste dhentë e tij afër Mekkes. Ebu Talibi ishte tregtar dhe shkonte e vinte për në Siri. Kur i mbushi 12 vjet me vete e mori edhe djalin e vëllait, pra Muhammedin e vogël. Ky prej tij e mësoi tregtinë, kështu që kur do të rritet do të bëhet një tregtar shumë i mirë.

Në moshën 25 vjeçare, Muhammedi a.s. filloi ta udhëhiqte tregtinë e Hatixhes, një grua e vejë dhe pasanike e Mekkes. Kur ajo e sheh zgjuarsinë, drejtësinë dhe bukurinë e Muhammedit të ri, nëpërmjet shoqes së saj Nefises i propozon Muhammedit të martohet me të. Muhammedi a.s. e pranon propozimin e saj dhe lidhin kurorë. Këta kalojnë një jetë shumë të lumtur bashkëshortore, prej të cilës martesë do të lindin gjashtë fëmijë, dy djem dhe katër vajza.

Djemtë e Muhammedit a.s. kanë qenë: Kasimi dhe Abdullahu; kurse vajzat e tij kanë qenë: Zejnebja, Rukija, Ummi Kulthumi dhe Fatimja.

Më pas Muhammedit a.s. i lind edhe një djalë i quajtur Ibrahim me gruan tjetër Merjemen.

Të gjithë fëmijët vdesin para Muhammedit a.s., përveç Fatimes e cila vdes gjashtë muaj pas vdekjes së Muhammedit a.s.

- vazhdon në mësimin e ardhshëm -

Detyrë shtëpie:

1. Kush është Muhammedi a.s., kur dhe ku është lindur?
2. Si janë quajtur prindërit e tij dhe sa kanë jetuar ata?
3. Kush kujdeset për Muhammedin a.s. pas vdekjes së nënës së tij?
4. Çka mësoi prej mixhës së tij Muhammedi a.s.?
5. Ç'bëri Muhammedi a.s. në moshën 25 vjeçare?
6. Sa fëmijë lindën prej martesës së Muhammedit a. s. me Hatixhen dhe kush ishin ata?
7. Sa kanë jetuar fëmijët e Muhammedit a.s.?

Mësimi 12

KUSH ËSHTË MUHAMMEDI A. S. ?

- vazhdon nga mësimi i kaluar -

Kur Muhammedi a. s. i mbushi 40 vjet, filloi të vetmohej në shpellën e quajtur "Hira". Në natën e Kadrit të Ramazanit të vitit 610, atij, për herë të parë, i erdhi meleku Xhebrail dhe i tha: "Ty, o Muhammed, All-llahu të ka zgjedhur për pejgamber dhe të ka ngarkuar që t'ia tregosh njerëzisë rrugën e drejtë, sipas urdhrave që do t'i japë vetë All-llahu i Madhëruar".



Kur filloi Muhammedi a.s. t'ua tregojë njerëzve këto urdhra të Zotit, disa e besuan, e disa jo vetëm që nuk e besuan, por edhe filluan ta urrejnë, t'i bëhen armiq dhe ta luftojnë.

Në atë kohë, populli i Mekkes i besonte për zot disa statuja prej guri, të cilat i kishin gdhendur me dorë të vet. Ata që besojnë në idhuj quhen idhujtarë, *mushrikë* ose politeistë. Muhammedi a.s. i thirri këta njerëz që të hiqnin dorë nga rruga e gabueshme e idhujtarisë dhe ta besonin Zotin e Vërtetë e të Madh.

Kjo thirrje e Muhammedit a.s. i hidhëroi idhujtarët e Mekkes, të cilët filluan ta mundonin shumë keq atë dhe shokët e tij, sa që Muhammedi a.s. në vitin 622 u detyrua të largohet prej Mekkes e të shkojë në një qytet tjetër, në Medine, që është afro 500 km larg Mekkes. Populli i Medines jashtëzakonisht mirë e priti Muhammedin a.s. dhe shokët e tij.

Hazreti Muhammedi në Medine e përhapi shumë shpejt fenë Islame, kështu që për pak kohë mësimet e shenjta të këtij burri të madh u përhapën në mbarë Arabinë. Kur Muhammedi a.s. i mbushi 63 vjet, në Arabi nuk kishte mbetur asnjë idhujtar, por të gjithë e kishin pranuar fenë Islami, pra ishin bërë muslimanë. Në këtë kohë, kur ishin plotësuar të gjithë urdhrat e Zotit, Muhammedi a.s. ndërron jetë.


Detyrë shtëpie:

1. Kur i erdhi Muhammedit a.s. meleku për herë të parë?
2. Çka i tha Xhebraili Muhammedit a.s. kur ai ishte në shpellën "Hira"?
3. Çka bënë njerëzit kur Muhammedi a.s. ua tregoi urdhrat e Zotit?
4. Çka besonte populli i Mekkes dhe si quheshin ata?
5. Ç'bëri Muhammedi a.s. në vitin 622?
6. Çka bëri Muhammedi a.s. kur shkoi në Medine?
7. Sa vjet kishte Muhammedi a.s. kur ndërroi jetë?

Mësimi 13

MORALI I MUHAMMEDIT A. S.

Muhammedi alejhis-selam (a.s.), i cili na e ka mësuar Kur'anin, ka qenë njeriu më i mirë, më i urtë e më i sjellshëm në botë.



Ai kurrë nuk ka bërë punë të liga. Ishte punëtor, e nuk ishte përtac. E siguronte jetën e vet e të familjes, duke punuar e fituar në mënyrë të ndershme.

Muhammedi a.s. ka qenë i pastër si në trup, ashtu edhe në sjellje. Ai ka qenë i rregullt dhe ka vepruar sipas programit të tij. Ai gjithnjë ka folur drejt dhe kurrë nuk ka gënjyer. Kënaqej me pak dhe nuk lakmonte shumë. Ka qenë njeri besnik dhe kurrë nuk ka tradhtuar.

Këtë njeri të lartë e të shenjtë duhet ta marrim si shembull, nëse dëshirojmë t'i përmirësojmë sjelljet e t'i rregullojmë punët tona në mënyrë të suksesshme.

Ja disa nga thëniet e tij:

“Puno për këtë botë, sikur nuk do të vdesësh kurrë; puno për botën tjetër (Ahiret) sikur do të vdesësh tani!”

“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman dhe muslimane”.

“Nëse nuk ke mbare, bëj çka të duash!”

“Nuk është besimtar i vërtetë ai që fqinjin e vet nuk e le të qetë”.

Detyrë shtëpie:

1. Çfarë njeriu ishte Muhammedi a.s.?
2. Si e siguronte ai jetën?
3. Numëro disa cilësi të Muhammedit a.s.!
4. Çka duhet të bëjmë ne me Muhammedin a.s.?
5. Ç'thotë Muhammedi a.s. për punën?
6. Ç'thotë Muhammedi a.s. për diturinë?
7. Ç'thotë Muhammedi a.s. për fqinjët?

Mësimi 14

BESIMI NË DITËN E KIJAMETIT (AHIRETIT)

Kushti i pestë i besimit islam është besimi në ditën e kijametit ose të ahiretit. Kur’ani na mëson se kjo botë është e përkohshme dhe se një ditë do t’i vijë fundi. Se kur është fundi i kësaj bote këtë nuk e di askush përveç Zotit.

Kur të vjen dita e fundit Zoti e urdhëron melekun Israfil që t’i fryjë surit për ta shkatërruar këtë botë. Me këtë do të shkatërrohet kjo botë me gjithë çka ka në të dhe Zoti do ta urdhërojë melekun Israfil që t’i fryjë surit për së dyti herë për ta krijuar botën tjetër, ahiretin.

Njerëzit prej Ademit a.s. e deri më sot që kanë vdekur, ata qëndrojnë në varreza. Kështu do të qëndrojnë deri kur të krijohet bota tjetër, Kijameti ose Ahireti.

Fjala “Kijamet” do të thotë: “ringjallje, ngjallje pasi të kemi vdekur një herë.” Te ne përdoret fjala “Qamet”. Kurse fjala tjetër është “Ahiret” që do të thotë: “e fundit”, “ajo çka vjen pas”, pra bota që vjen pas kësaj dunjaje dhe e cila është e fundit, pas saj nuk ka botë tjetër.

Ahireti ose Kijameti është bota tjetër pas kësaj ku jetojmë ne sot. Me urdhrin e Zotit të gjithë njerëzit prej njeriut të parë Ademit a.s. e deri te njeriu i fundit që do ta zërë Kijameti në këtë botë, të gjithë do të ringjallen dhe do të dalin përpara Zotit, All-llahut xh. sh. Kjo ndryshe quhet edhe “Mahsher” ose vend tubimi përpara Zotit.

Në Ahiret Zoti do t’i pyesë njerëzit se çka kanë bërë në këtë botë, pra në dunja. Pejgamberi a.s. na mëson se Zoti në fillim do t’i pyesë njerëzit për namazin si dhe për 5 sende kryesore e pastaj edhe për çdo punë tjetër. Ato 5 pyetjet janë: 1. Ku dhe si e ke kaluar jetën në dunja? 2. Ku e ke harxhuar rininë tënde? 3. Ku e ke fituar mallin, pasurinë? 4. Ku e ke harxhuar pasurinë? dhe 5. Çka ke bërë me diturinë që ke pasur?

Pasi njerëzit të pyeten nga Zoti për krejt këto që i kanë bërë në dunja, atëherë do të shkojnë ose në Xhennet ose në Xhehennem. Ata që kanë qenë besimtarë dhe kanë bërë punë të mira në dunja, do të shkojnë në Xhennet, kurse ata që nuk kanë besuar dhe nuk kanë bërë punë të mira por vetëm të këqija, do të shkojnë në Xhehennem.

Ne muslimanët të gjithë do të shkojmë në Xhennet. Për disa punë të këqija që i kemi bërë, nëse nuk na falë Zoti, do të dënohemi në Xhehennem e pastaj do të dalim përfundimisht në Xhennet.

Ahireti është një botë që nuk ka fund. As xhehennemi e as xhenneti nuk kanë fund.

Detyrë shtëpie:

1. Çka është kushti i pestë i besimit islam?
2. Çka ndodh kur të vjen dita e fundit në këtë botë?
3. Çka do të thotë fjala “Kijamet” dhe çka “Ahiret”?
4. Çka është Ahireti ose Kijameti?
5. Çka bën Zoti në Kijamet?


Mësimi 15

XHENNETI DHE XHEHENNEMI

Fjala **Xhennet** do të thotë: “kopsht”, “bahçe”. Kurse sipas fesë Xhennet do të thotë një kopsht ku do të pushojnë e do të kënaqen besimtarët me të mirat që ndodhen aty. Xhenneti dhe jeta në të është e pafund.

Në Kur’an për Xhennetin përmenden edhe emra të tjerë, si: Me’va, Adn, Darul-Huld, Firdeus, Darus-Selam Darul-Mukameh, Xhennetun-Neim...

Kur’ani kështu e përshkruan Xhennetin: vend i flladshëm, me hije të mëdha, me mot pranvere, me lumenj në të cilët rrjedh qumësht dhe mjaltë, me pije të ndryshme e ujë të kulluar, me pemë e perime të ndryshme, hurma, shegë, rrush, banane; me mish shpezësh të ndryshme, me shërbëtorë të panumërt, me pallate të ngritura mbi njëri-tjetrin, me pushim dhe hiç pa lodhje e dhimbje...



Sipas një hadithi të Muhammedit a.s., All-llahu xh.sh. ka thënë: *“Në Xhennet për ata që meritojnë të hyjnë në të, kam përgatitur shumë sende të mira që syri kurrë nuk i ka parë, veshi kurrë nuk i ka dëgjuar dhe truri kurrë nuk i ka menduar”.*

Kënaqësia më e madhe e xhennetlinjve do të jetë momenti kur ata për çdo ditë mëngjes e mbrëmje do ta shohin All-llahun xh.sh.

Fjala **Xhehennem** do të thotë: “gropë” ose “pus” i thellë. Kurse sipas fesë Xhehennem do të thotë një gropë e madhe e mbushur plot zjarr e flakë në botën tjetër, ku do të dënohen njerëzit që nuk i kanë besuar Zotit dhe që kanë qenë të këqij në këtë botë.

Mosbesimtarët do të dënohen në Xhehennem përgjithmonë, pa fund. Kurse besimtarët mëkatarë do të dënohen aq sa kanë gabuar.

Dënimi në Xhehennem bëhet ashtu që melekët e fusin mëkatarin në zjarr dhe pasi të shkrihet tërësisht, ata e nxjerrin prapë, e veshin me mish e lëkurë, pra ia japin formën si e ka njeriu, e pastaj përsëri e fusin në zjarr...

Në Kur’an për xhehenemin përdoren edhe emra të tjerë, si: Nar (zjarr), Xhehim (zjarr shumë i madh), Havijeh (greminë), Seir (zjarr i hutuar), Ledhdha (flakë pa tym), Sekar (zjarr përvëlues), Hutameh (zjarr i fortë).

Detyrë shtëpie:

1. Çka do të thotë “Xhennet”?
2. Si e përshkruan Kur’ani Xhennetin?
3. Çka do të thotë “Xhehennem”?
4. Si bëhet dënimi në Xhehennem?

Mësimi 16

BESIMI NË KADERIN DHE KADANË E ZOTIT

Kushti i gjashtë i besimit islam është besimi në kaderin dhe kadanë e Zotit.

Fjala “kader” do të thotë: caktim, fat, kismet; kurse si term islam do të thotë se Zoti qysh në “ezel” (para-kohë, para-histori) ka caktuar për shumëçka që ndodh në natyrë, si: lindja e njerëzve dhe vdekja e tyre, rënia e shiut, e borës dhe e fenomeneve të ndryshme në natyrë...

Fjala “kada” do të thotë: realizim, kryerje, çuarje në vend; kurse si term islam do të thotë që Zoti ta realizojë, ta çojë në vend atë që e ka caktuar në para-kohë. Kur të vijë momenti që Ai e ka caktuar të lindë një fëmijë, Zoti i krijon të gjitha mundësitë që ai fëmijë të lindë dhe nuk ka mundësi të mos lindë. E njëjta vlen edhe për vdekjen, për reshjet në natyrë, tërmetin, vullkanin etj.

Ne si muslimanë besojmë se All-llahu xh.sh. është Krijues edhe i të mirës edhe i të keqes, mirëpo Ai nuk është i kënaqur me punën e keqe. Njeriu është i lirë në punët të cilat Zoti e ka lënë të lirë. Njeriu është i lirë të besojë ose të mos besojë, të punojë ose të mos punojë, të flejë ose të mos flejë, të ecë ose të mos ecë, të mësojë ose të mos mësojë... Mirëpo ai nuk është i lirë të vendosë se a do të lindet ose jo, se a do të vdesë ose jo, njeriu nuk mund të vendosë se kur do të bjerë shi e kur jo...

Prandaj, njeriu është përgjegjës për veprat dhe sjelljet që ai i kryen me vullnetin e vet të lirë. Nëse njeriu dëshiron të hajë ushqim Zoti ia mundëson njeriut të hajë ushqim, kur njeriu dëshiron të flejë Zoti ia mundëson të flejë, kur ai dëshiron të ecë Zoti ia mundëson të ecë, pra ia jep krejt kushtet për të ecur. Kur njeriu dëshiron t’i ndihmojë dikujt e të bëjë ndonjë punë tjetër të mirë, Zoti ia mundëson këtë. Po edhe kur njeriu dëshiron të bëjë ndonjë punë të keqe, si të pijë alkool, të rrejë, të rrihet me dikë, Zoti ia mundëson edhe këtë, mirëpo Zoti nuk është i kënaqur me këtë punë të keqe që njeriu dëshiron ta bëjë.

Për punët dhe sjelljet e mira që i bën njeriu All-llahu xh. sh. është i kënaqur dhe do ta shpërblejë njeriun me xhenet, kurse Ai nuk është i kënaqur me punët e këqija të njeriut, prandaj edhe do ta dënojë me xhehenem.

Detyrë shtëpie:

1. Ç’do të thotë fjala “kader”?
2. Çka do të thotë fjala “kada”?
3. Në çka besojmë ne muslimanët lidhur me All-llahun xh.sh.?
4. Për cilat vepra dhe sjellje njeriu është përgjegjës?

Mësimi 17

LITARI DHE GURI



Kishte qenë një herë një plak të cilit nipi i tij i kishin thënë:

- Na trego, o gjysh, një ngjarje të vjetër!

- S'kam çka të tregoj, or bir – tha gjyshi – nuk është vonë kurrë për të mësuar. Unë pas pesëdhjetë vjetëve të mia kam mësuar shkrim e lexim, se përpara nuk kam ditur emrin tim ta shkruaj. Kur shkoja diku skuqesha nga turpi se nuk dija shkrim e lexim. Një ditë prej ditësh e dëgjova hoxhën duke ligjëruar dhe tha se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kërkojeni diturinë prej djepi e deri në varr!”*. Kjo do të thotë mundohu të mësosh sa të jesh gjallë, prej lindjes e deri sa të vdesësh.

Pastaj e dëgjova edhe një kallëzim tjetër prej babait tim, çka ma shtoi edhe më shumë dashurinë për ta mësuar shkrimin e leximin.

- Cili ishte ai kallëzim! – e pyeti nipi gjyshin.

- Një fëmijë një herë kishte shkuar katër vjet në shkollë dhe s'kishte mësuar kurrëgjë. Kur mësuesit e panë se ky nuk dinte gjë, dhe kur u bind edhe vetë ky se nuk mund të mësonte, e la shkollën. Mirëpo, një ditë kaloi pranë një pusi dhe u afrua të pijë ujë. Pusi ishte i ndërtuar prej gurëve të renditur bukur. Kur afrohet te pusi ta lëshojë litarin të nxjerrë ujë për të pirë, në gurë e sheh një vijë dhe fillon të mendohet vetë me vete: “Kush e ka bërë në gur këtë vijë?!”. Duke u menduar kështu, aty erdhi edhe një plak dhe e pyeti plakun për këtë vijë. Plaku i tha se këtë vijë e ka bërë litari vazhdimisht duke e lëshuar njerëzit poshtë e duke e nxjerrë lart. Atëherë ky djali tha vetë me vete: “Gurit i është shënuar kjo vijë nga litari, kurse mua për katër vjet radhazi nuk m'u ngulit asgjë në tru”. Dhe u betua se do ta mbarojë shkollimin. Dhe vërtet, ky djalë pastaj u bë nxënës i shkëlqyeshëm në sjellje e në mësim.

Detyrë shtëpie:

Shkruaje tekstin ashtu siç është.

Mësimi 18

NETËT DHE DITËT E MIRA (TË MËDHA)

Festat fetare të muslimanëve nuk llogariten me kalendarin e diellit, por me kalendarin e hënës.

Sipas kalendarit të hënës (lunar), viti ka po ashtu 12 muaj dhe secili prej tyre fillon me hënën e re. Emrat e muajve hënor janë këta:

1. Muharrem, 2. Safer, 3. Rebiu'l-Evvel, 4. Rebiu'l-Ahir, 5. Xhemadije'l-Ula, 6. Xhemadije'l-Ahir, 7. Rexheb, 8. Shaban, 9. Ramadan (Ramazan), 10. Shevval, 11. Dhu'l-Kade, 12. Dhu'l-Hixhxhe.

Në disa nga këta 12 muaj ka disa ditë e disa net të bekuara që i kremtojnë muslimanët dhe quhen "data të mëdha". Këto janë si vijojnë më poshtë:

1. Dita e dhjetë (10) e Muharremit është Dita e Ashuras,
2. 12 Rebiu'l-Evveli është dita e madhe e lindjes së Muhammedit a.s. Nata para kësaj quhet "Nata e Mevludit",
3. Nata e madhe e "Regaibit" është nata e së premtes së parë të muajit Rexheb,
4. Nata e madhe e "Israsë dhe Miraxhit", bie në natën e 27 të muajit Rexheb,
5. Nata e madhe e "Beratit", bie në natën e 15 të muajit Shaban,
6. I tërë muaji i Ramazanit, kur muslimanët agjërojnë,
7. Nata e madhe e "Kadrit", e cila bie në natën e 27 të Ramazanit,
8. "Bajrami i Ramazanit" ose "Bajrami i Madh", bie në tre ditët e para të muajit Shevval, sapo të mbarojë Ramazani,
9. "Dita e Arifes" ose "Dita e Arafatit", bie në ditën e 9 të Dhu'l-Hixhxhes,
10. "Bajrami i Kurbanit" ose "Bajrami i Vogël" ose "Bajrami i Haxhxhit", bie katër ditë rresht pas "Ditës së Arafatit".

Këto ditë net të mëdha dhe këto festa fetare, muslimani duhet t'i kalojë me dua dhe lutje, duhet të kërkojë prej Zotit falje të gabimeve e mëkateve që i ka bërë në të kaluarën. Në këto data të mëdha fetare muslimani duhet t'ia japë besën All-llahut xh.sh. se nuk do të gabojë më dhe se nuk do të bëjë asnjë mëkat me vetëdije.

Detyrë shtëpie:

1. Si llogariten festat fetare të muslimanëve?
2. Cilët janë emrat e muajve hënorë?
3. Cilat janë festat e muslimanëve?
4. Çka duhet të bëjë muslimani në këto festa?

Mësimi 19

IBADETI NË ISLAM

Fjala “ibadet” është një fjalë arabe e cila nënkupton: dëgjueshmëri, adhurim, përkulje...

Si term islam “ibadet” nënkupton çdo fjalë, vepër apo sjellje të mirë që e bën njeriu dhe me të cilën është i kënaqur All-llahu xh.sh.

Ibadet janë për shembull: namazi, agjërimi, zekati, haxhi, respektimi i prindërve, sjellja e moralshme me njerëz, kujdesi ndaj natyrës dhe kafshëve, kujdesi ndaj vetvetes dhe familjes, mësimi në shkollë e xhami..



All-llahu xh.sh. në Kur'an na njofton se qëllimi i krijimit të njeriut dhe xhinve është “që t'i bëjnë ibadet All-llahut xh.sh.”. Në suren edh-Dharijat (51) ajeti 56 Zoti thotë: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër gjë, pos që të më adhurojnë”. Kurse në ajetin 99 të sures el-Hixhr (15), Ai na thotë: “Dhe adhuroje Zotin tënd deri sa të vijë ty e vërteta (vdekja)”. Kjo do të thotë se ne jemi të obliguar ta adhurojmë Zotin sa të jemi gjallë e deri në vdekje.

Kush është i obliguar me ibadet? Me ibadet është i obliguar personi i cili i plotëson këto tri kushte:

1. **Të jetë musliman** – ai që nuk është musliman nuk është i obliguar me ibadete, ai njëherë duhet të bëhet musliman.
2. **Të jetë i mençur** – të mund ta dallojë të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e shtrembëta. Njeriu që nuk ka mend, nuk është i obliguar me ibadete.
3. **Të jetë i rritur** – pra, në moshën madhore (në pubertet). Mashkulli hyn në pubertet kur për herë të parë ejakulon në ëndërr, kurse femra kur asaj për herë të parë i paraqiten menstruacionet. Fëmija që akoma nuk ka hyrë në bylyg (pubertet), nuk është i obliguar me ibadetet, mirëpo në qoftë se i kryen ato, fiton sevape, e nëse jo nuk dënohet për këtë.

Ibadetet ndahen në: farz, vaxhib, sunnet, nafile... për çka do të flasim në mësimin e ardhshëm.

Detyrë shtëpie:

1. Çka do të thotë termi “ibadet” dhe përmendi disa ibadete si shembull?
2. Çka është qëllimi i krijimit tonë sipas Kur'anit?
3. Kush është i obliguar me ibadet?

Mësimi 20

PUNËT E MUSLIMANIT

Punët e muslimanit ndahen në 7 kategori:

1. Farz: Janë punët që All-llahu xh.sh. drejtpërdrejtë dhe qartë në Kur'an na ka urdhëruar t'i bëjmë, si: të besojmë Zotin, të falim namaz, të agjërojmë, t'i dëgjojmë prindërit etj.

Farzi ndahet në: **a) Farzi ajn** – detyrë që duhet secili musliman ta bëjë vetë, si: namazi, agjërimi etj. dhe **b) Farzi-kifajeh** – detyra që nëse dikush i bën, të tjerët lirohen prej obligimit, e nëse nuk i bën askush atëherë të gjithë janë përgjegjës, si: namazi i xhenazes, të bëhesh doktor (mjek), të bëhesh hoxhë, të bëhesh mësues etj.

2. Vaxhib: janë punët që All-llahu xh.sh. jo drejtpërdrejtë, porse tërthorazi (indirekt) na ka urdhëruar t'i bëjmë, si: falja e namazit të vitrit, të bajramit, të presësh kurban, të japësh sadaka etj.

3. Sunnet: Janë punët që i ka bërë Pejgamberi a.s. dhe që na ka porosit edhe neve t'i bëjmë.

Sunneti ndahet në: **a) Sunneti-mu'ekkede** – janë punë që Pejgamberi a.s. i ka bërë shpesh dhe shumë rrallë i ka lënë pa i bërë, si: sunnetet e sabahut dhe të drekës, ngrënia me dorë të djathtë, të bëjmë bismil-lah kur të hamë bukë, kur hyjmë në derë, kur veshim teshat etj. dhe **b) Sunneti- gajri mu'ekkede** – janë punë që Pejgamberi a.s. disa herë i ka bërë e disa herë nuk i ka bërë, si: sunnetet e ikindisë e të jacistë...

4. Mustehab: janë punë që Pejgamberi a.s. ka thënë se janë të pëlqyeshme të bëhen dhe se ka sevap nëse bëhen, si: të japësh lëmoshë (sadaka) nafile, të agjërosh nafile (vullnetarisht), të falësh namaz nafile etj.

5. Mubah: janë punë që mund edhe të bëhen edhe të mos bëhen dhe nuk ka mëkat nëse nuk bëhen, si: të ecësh, të ulesh, të flesh etj.

6. Haram: janë punë që All-llahu xh.sh. na ka ndaluar rreptësisht t'i bëjmë, si: të mos falësh namaz, të mos agjërosh kur ke mundësi, të rresh, të pish alkool, të hash mish derri etj.

7. Mekruh: janë punë të papëlqyeshme dhe që nuk është mirë të bëhen.

Mekruhi ndahet në: **a) Mekruh tenzihen** – mekruh më afër lejesës apo hallallit, si: ngrënia me dorë të majtë, pastrimi i hundës me dorë të djathtë etj. dhe **b) Mekruh tahrimen** – mekruh më afër ndalesës apo haramit, si: vonimi i namazit pa nevojë, pirja e duhanit etj.

Detyrë shtëpie:

1. Çka do të thotë "farz" dhe si ndahet ai?
2. Çka është sunneti dhe si ndahet?
3. Çka do të thotë "haram"?
4. Çka do të thotë "mekruh" dhe si ndahet ai?

Mësimi 21

SHEHADETI

Kushti i parë i fesë islame është Shehadeti.

Shehadet do të thotë të besosh me zemër e të dëshmosh me gojë se ka vetëm një Zot, All-llah, dhe se Muhammedi a.s. është peygamber i Tij.

Për t'u quajtur dikush musliman, më së paku një herë në jetë ai duhet ta thotë me gjithë zemër e me plot besim shehadetin. Prandaj, nëse dikush që nuk është musliman dëshiron të bëhet musliman dhe pyet se çka duhet të bëjë që të quhet musliman, ne do t'i përgjigjemi se ai duhet ta thotë shehadetin me gjithë zemër e me plot bindje.

Shehadeti mund të thuhet ose në gjuhën arabe ose në atë gjuhë që e di më mirë.

Shehadeti në gjuhën arabe është: **“Esh’hedu el-la ilahe il-lall-llah ve esh’hedu enne Muhammeden abduhu ve rasuluhu”**.

Në gjuhën shqipe shehadeti përkthehet kështu: **“Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe peygamber i Tij”**.

Muslimani i vërtetë jo vetëm një herë në jetë, porse disa herë në ditë dhe atë sa më shpesh që mundet duhet ta shpotojë shehadetin.

Akoma më shumë rëndësi ka që muslimani ta besojë me zemër, ta shprehë me gojë dhe ta manifestojë në vepër besimin në Zot dhe në Peygamberin e Tij, duke jetuar sipas fjalëve e porosive të Zotit që janë në Kur’an dhe sipas fjalëve e porosive të Muhammedit a.s. që janë në përmbledhjet e haditheve.



Detyrë shtëpie:

1. Ç'do të thotë shehadet?
2. Për t'u quajtur musliman, çfarë duhet bërë?
3. Si shqiptohet shehadeti në gjuhën arabe?
4. Si shqiptohet shehadeti në gjuhën shqipe?

Mësimi 22

PASTËRTIA NË ISLAM

Pastërtia është një prej bazave të cilës Islami i ka dhënë një rëndësi të madhe.

All-lahu xh.sh. në Kur'an, në suren e dytë el-Bekara, ajeti 222, thotë: *“Vërtet All-llahu i do ata që pendohen dhe i do ata që pastrohen”*. Kurse Muhammedi a.s. është shprehur disa herë për rëndësinë e pastërtisë në islam duke thënë: *“Pastërtia është gjysma e imanit (besimit)”*.

Në islam kemi 3 lloje të pastërtisë: 1. Pastërtia e shpirtit, 2. Pastërtia e trupit, dhe 3. Pastërtia e mjedisit (rrethit).

1. Pastërtia e shpirtit: Në rend të parë kjo pastërti arrihet me pastrimin e shpirtit nga besimi i kotë dhe i shtrembëruar. Pastaj me pastrimin e shpirtit prej ndjenjave të këqija sikurse që janë urrejtja, xhelozia, mendjemadhësia, armiqësia, dyfytërsia etj.

2. Pastërtia e trupit: nënkupton pastrimin e të gjitha organeve të trupit si dhe pastrimin e teshave që i veshim. Pastërtia e trupit para së gjithash arrihet duke marrë abdest 5 herë në ditë, duke i pastruar dhëmbët vazhdimisht, duke i larë duart para e pas ushqimit, duke bërë pastrimin e nevojshëm me ujë pas kryerjes së nevojës së vogël e të madhe, duke bërë prerjen e rregullt të thonjve e të qimeve ndër sqetulla dhe te vendet e turpshme, duke marrë gusul më së paku një herë në javë etj.

Pejgamberi a.s. për rolin e abdestit ka thënë: *“Nëse një njeri ka një lumë para dyerve dhe pesë herë në ditë pastrohet në të, a i ngel ndonjë papastërti?”* I thanë: “Jo, o Pejgamber i Zotit”. Atëherë ai tha: *“Po kështu është dhe me abdestin, ai person që pesë herë në ditë merr abdest, atij i lahen mëkatet që janë bërë midis dy namazeve”*. Ai po ashtu ka thënë: *“Sikur mos të ishte rëndë, do ta kisha porosit ummetin tim që t’i pastrojë dhëmbët me misvak para çdo namazi”*.

3. Pastërtia e mjedisit: Mjedisin apo rrethin tonë e përbëjnë: shtëpia jonë, oborri ynë, rruga jonë, mëhalla apo lagjja jonë, vendi ku punojmë e mësojmë si dhe gjithë natyra ku ne jetojmë. Nëse ne e kemi të pastër shpirtin dhe trupin, nuk mund të paramendohet ta kemi të papastër rrethin ku jetojmë. Prandaj, nëse ne rrethin e kemi të pastër, kjo do të thotë se edhe shpirtin edhe trupin i kemi të pastër, e nëse rrethin e kemi të përlyer, kjo do të thotë se edhe shpirtin e trupin i kemi të përlyer. Muhammedi a.s. ka thënë: *“Mjedisin dhe shtëpitë tuaja mbani të pastra... Në një shtëpi ku ka hedhurina e papastërti, aty nuk ka bereqet”*.

Detyrë shtëpie:

1. Çka thotë All-llahu xh.sh. në Kur'an dhe Muhammedi a.s. për rolin e pastërtisë në Islam?
2. Si ndahet pastërtia?
3. Çka është pastërtia e shpirtit?
4. Çka është pastërtia e trupit dhe si arrihet ajo?
5. Çka është pastërtia e mjedisit dhe çka ka thënë Muhammedi a.s. për të?

Mësimi 23

ABDESTI DHE TEJEMMUMI

Abdesti është një pastrim i domosdoshëm të cilin feja islame e kërkon prej muslimanit kur ai duhet të falë namaz, kur dëshiron të lexojë Kur'an dhe kur dëshiron ta bëjë tavaf Qaben. Pra, këto janë disa punë që nuk mund të bëhen pa abdest.


Abdest merret në këtë mënyrë: së pari lexojmë “Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir-raxhim. Bismil-lahir-rahmanir-rahim”, pastaj tri herë i lajmë duart deri mbi koc duke i fërkuar mirë ndërmjet gishtave, pastaj e shpërlajmë gojën tri herë, pastaj hundën po ashtu tri herë. Më pas e lajmë fytyrën prej ku kanë mbirë flokët e deri nën mjekër dhe prej veshi e deri në veshin tjetër. Pastaj e lajmë krahun e djathtë tri herë deri mbi bërryl, e pastaj edhe të majtin njësoj. Më pas me dorë të lagur e fërkojmë (mes'h) së paku çerekun ($\frac{1}{4}$) e kokës. I lagim duart sërish dhe i fërkojmë veshët e pastaj edhe qafën. Më në fund e lajmë këmbën e djathtë tri herë deri mbi zog, e pastaj njësoj edhe të majtën.

Abdesti priset nëse e bëjmë cilëndo nevojë fiziologjike, nëse prej trupit tonë rrjedh gjak ose limfë, nëse vjellim, nëse na zë gjumi dhe flemë.

Kur nuk kemi ujë për të marrë abdest, ose kur kemi ujë mirëpo është shumë ftohët dhe nuk kemi mundësi ta ngrohim ujin, atëherë marrim tejjemmum për të gjitha ato punë për të cilat duhet të marrim abdest.

Tejjemmumi merret kështu: bëhet nijet (vendoset), pastaj i vëmë duart në dhe (tokë) të pastër dhe i biem një herë fytyrës, pastaj përsëri i vëmë duart në tokë dhe me dorën e majtë e fërkojmë një herë krahun e djathtë e pastaj me dorën e djathtë e fërkojmë krahun e majtë.

Tejjemmumin e prish çdo gjë që e prish edhe abdesin, si dhe gjetja e ujit ose e mundësisë për ta ngrohur ujin.

**Detyrë shtëpie:**

1. Ç'është abdesti dhe kur duhet të merret?
2. Si merret abdest?
3. Kur priset abdesti?
4. Çka bëjmë kur nuk kemi ujë për abdest?

Mësimi 24

GUSLI

Gusël është larja islame e krejt trupit pa mos mbetur asnjë pjesë e tij pa u lagur.

Gusli ndonjëherë është farz, ndonjëherë sunnet e ndonjëherë mustehab.

Gusli është farz të merret në këto raste: pas ejakulimit të burri ose gruaja, pas menstruacionit të rregullt mujor dhe pas menstruacionit me rastin e lindjes së fëmijës të gratë.


Gusli është sunnet në këto raste: për namazin e xhumasë dhe bajramit, për të veshur ihramet për haxh ose umre...

Gusli është mendub në këto raste: kur të pendohemi për ndonjë mëkat, kur të dhurojmë gjak, kur të kthehemi nga udhëtimi i gjatë, kur të veshim tesha të reja, në netët e mëdha të Kadrit, Beratit, Israsë e Miraxhit etj.

Gusli ka 3 farze: 1. Shpëlarja e gojës mirë deri në fyt, 2. Shpëlarja e hundës mirë deri thellë në zgavër dhe 3. Larja e krejt trupit pa mos mbetur ndonjë pjesë pa u lagur, të gjitha këto nga një herë.

Sunnetet e guslit janë: Të bësh nijet për gusël, të lexosh “Bismil-lahin”, të pastrosh dhëmbët me brushë ose misvak, të pastrosh duart, pastaj vendet e turpshme, pastaj të marrësh abdest sikur për namaz por pa lexuar dua (lutje), pastaj ta lash kokën, pastaj anën e djathtë e pastaj anën e majtë, të mos harxhosh shumë ujë, të mos flasësh gjatë guslit...

Personi që nuk ka gusël nuk guxon të falë namaz, të lexojë Kur’an, ta prekë Kur’anin, të bëjë tavaf Qaben, të hyjë në xhami pa pasur nevojë.



Detyrë shtëpie:

1. Çka është gusli?
2. Kur është farz të merret gusël?
3. Sa farze ka gusli?
4. Sa sunnete ka gusli?
5. Çka nuk guxon të bëjë personi që nuk ka gusël?

Mësimi 25

NAMAZI DHE RËNDËSIA E TIJ NË ISLAM

Namazi është një prej rregullave kryesore në Islam dhe është ibadeti që më së shumti përmendet në Kur'an.

Të gjithë pejgamberët dhe ndjekësit e tyre në një farë forme kanë falur namaz, ndoshta jo sikurse ne, porse një lloj ibadeti a lutjeje e kanë kryer.

Namazi është bërë obligim (farz), një vit e gjysmë para hixhretit (620), në natën e Miraxhit.

Namazi është farz për çdo musliman e muslimane që janë të mençur dhe në moshën madhore (pubertet ose arab. "bulug").

Një njeri një herë e pyeti Muhammedin a.s. se çfarë dobie kemi prej namazit, ai iu përgjigj: *"Nëse para dyerve tuaja keni një lumë dhe në atë lumë laheni 5 herë në ditë, a mbetet në trupin tuaj ndonjë ndyrësi? I këtillë është edhe namazi."* Kurse All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"Me të vërtetë namazi të pengon nga e keqja dhe e shëmtuara"*.

Ja edhe disa dobi tjera të namazit: namazi është gjendja kur njeriu është më afër Zotit, është pastrim fizik dhe shpirtëror, është energji shpirtërore, e ngre moralisht njeriun, e freskon shpirtin dhe i shton kënaqësinë, e largon nga çdo e keqe, ia mëson njeriut disiplinën, i bashkon të gjithë muslimanët në një *saff* (resht) pa marrë parasysh ngjyrën, gjuhën, kombësinë apo vendin...

Kemi disa lloje të namazit:

1. Namaze farz (5 namazet e ditës, namazi i xhumasë dhe namazi i xhenazes)
2. Namaze vaxhib (namazi i vitrit dhe namazet e dy bajrameve)
3. Namaze sunnet apo nafile (namazet sunnet para dhe pas namazeve farz, namazi i teravisë, namazi i natës, namazi i *duhasë* [para ditës] etj.)

Detyrë shtëpie:

1. A kanë falur namaz edhe pejgamberët e mëparshëm?
2. Kur është bërë farz namazi?
3. Çka thotë Muhammedi a.s. për namazin?
4. Çka thotë Kur'ani për namazin?
5. Sa lloje të namazit kemi? Numëroji!



Mësimi 26

PARAKUSHTET E NAMAZIT

Namazi ka 12 kushte: 6 para se të hyjmë në namaz dhe 6 pasi të hyjmë në namaz.

Gjashtë kushtet para se të hyjmë në namaz janë:

1. Marrja e abdestit, sipas nevojës duhet marrë edhe gusël. Njeriu që nuk ka abdest, nuk mund të falë namaz, ai namaz quhet i pavlefshëm. Po ashtu, nëse njeriu është xhunub ose gruaja pas menstruacionit, nuk guxojnë të falin namaz para se të marrin gusël.

2. Të jetë i pastër trupi, rrobat dhe vendi ku do të falemi nga ndyrësitë e njeriut, të kafshëve ose shpezëve. Nëse trupi ynë ose rrobat apo vendi ku do të falemi janë të përlyera me ndyrësi të këtilla, ne nuk guxojmë të falim namaz para se t'i largojmë ato.

3. Të mbulohet *avreti*, pjesa e turpshme e trupit, që nuk guxon të mbetet e zbuluar si karshi njerëzve ashtu edhe karshi Zotit. Avreti i grave është tërë trupi, përveç fytyrës, duarve dhe këmbëve, kurse te burrat prej kërthize e deri nën gjunjë. Mirëpo, kjo assesi nuk nënkupton se burrat duhet të zhvishen prej kërthize e më lart e prej gjunjëve e më poshtë. Kështu mund të veprojnë vetëm kur nuk kanë çka të veshin, përndryshe duhet ta mbulojnë edhe burrat tërë trupin.

4. Drejtimi kah Kibla ose Qabeja që gjendet në qytetin e Mekkes në Arabinë Saudite. Të gjithë muslimanët e botës kudo që të jenë, gjatë faljes së namazit duhen drejtuar kah Mekka. Në rast se nuk e dinë këtë drejtim, atëherë orientohen sipas diellit, hënës etj. Prej shteteve evropiane Mekka gjendet në drejtimin jug-lindje. Sot ka mjaft programe interneti dhe aplikacione të telefonave celularë që e mundësojnë gjetjen e Kibles. Në rast se prapëseprapë nuk e gjen dot drejtimin e Qabes, atëherë falesh në drejtimin që më së shumti ta merr mendja se andej mund të jetë.

5. Namazi të falet në kohën e caktuar. Pesë namazet e ditës kanë kohët e tyre të caktuara se kur mund të falen. Për këtë muslimanët përdorin kalendarët e fesë. Namazi i falur para kohe nuk vlen, ai duhet falur edhe njëherë pasi të hyjë koha e tij. Namazin që nuk kemi mundur ta falim në kohën e vet për shkak të punës ose angazhimeve tjera, duhet ta falim më vonë *kaza*, duke kërkuar falje e pendim prej Zotit.

6. Bërja e nijetit. Nijet do të thotë të vendosësh me zemër dhe ta thuash me fjalë atë se cilin namaz je duke e falur dhe të mundohesh ta harrosh dunjanë dhe të jesh në kontakt me All-llahun xh.sh.

Nëse nuk e kryejmë ndonjërin prej këtyre kushteve para namazit, ne nuk kemi mundësi të falim namaz. Nëse eventualisht e falim namazin pa e kryer ndonjërin prej këtyre kushteve, atë namaz duhet ta përsëritim.

Detyrë shtëpie:

1. Sa kushte ka namazi?
2. Numëroji shkurtimisht 6 kushtet para namazit?
3. Çka ndodh nëse nuk e kryejmë ndonjë kusht të namazit?

Mësimi 27

PJESËT E BRENDSHME TË NAMAZIT

Përveç 6 parakushteve, namazi ka edhe 6 pjesë apo farze të brendshme.

Gjashtë pjesët e brendshme të namazit janë:

1. Tekbiri fillestar. Fjala “tekbir” do të thotë të thuash “All-llahu ekber” (All-llahu është më i madhi). Me këtë rast burrat i ngrenë duart deri te veshët dhe me gishtat e mëdhenj i prekin puplat e veshëve, kurse gratë deri në drejtim të shpatullave, me shuplaka drejt kibles duke thënë “All-llahu ekber”.
2. Qëndrimi në këmbë. Personat që nuk kanë mundësi fizike ose janë të sëmurë dhe nuk mund të qëndrojnë gjatë kohë në këmbë, ata namazin mund ta falin edhe ulur në karrige ose edhe ulur në tokë. Me këtë rast ata rukunë e bëjnë duke u përkulur pak përpara, kurse sexhden edhe pak më shumë se rukunë, por pa e vënë ballin në sexhde. Në këtë formë falet edhe namazi në autobus, aeroplan etj.
3. Këndimi i Kur’anit. Derisa jemi në këmbë të lexojmë diçka nga Kur’ani është farz. Pra çka do që të lexojmë prej Kur’anit mjafton, mirëpo leximi i sures së parë Fatiha është vaxhib (detyrë nën farzin). Po ashtu edhe leximi i një sure të shkurtër ose i disa ajeteve pas Fatihës është vaxhib.
4. Përkulja në ruku. Me këtë rast e përkulim kokën përpara dhe me duart tona i kapim gjunjët kurse shpina rri rrafsh dhe paralel me tokën.
5. Rënia në sexhde. Sexhdeja quhet e plotë vetëm nëse në tokë e vendojmë përnjëherësh ballin, hundën, dy duart, dy gjunjët dhe majat e gishtave të këmbëve.
6. Qëndrimi ulur në fund të namazit. Te namazet prej dy rekatesh në fund të dy rekateve, te namazet prej 3 rekatesh në fund të 3 rekateve dhe te namazet prej 4 rekatesh në fund të 4 rekateve të ulemi sa ta këndojmë ettehijjatin është farz. Leximi i salavateve dhe i duave pas ettehijjatit është sunnet.



Nëse nuk e kryejmë ndonjërin prej këtyre kushteve brenda namazit, ne nuk e kemi namazin të plotë, andaj edhe këtë namaz duhet ta përsëritim.

Detyrë shtëpie:

1. Numëroji 6 kushtet e brendshme të namazit?
2. Çka ndodh nëse nuk e kryejmë ndonjë kusht të brendshëm të namazit?

Mësimi 28

AGJËRIMI I RAMAZANIT

Agjërim do të thotë: “Prej imsaku e deri në iftar të mos hash, të mos pish dhe të mos bësh punë të tjera që e prishin agjërimin dhe krejt këtë ta bësh vetëm si ibadet për Allahun xh.sh. Agjërimi është shtylla e tretë e islamit, pas shehadetit dhe namazit.

Agjërimi farz është ai i muajit të Ramazanit. Muaji Ramazan është muaji i nëntë sipas kalendarit islam.

All-llahu xh.sh. në ajetin 183 të sures el-Bekara thotë: *“O ju besimtarë, ju është bërë obligim (farz) agjërimi, ashtu siç ka qenë farz edhe për ata përpara jush, me qëllim që të bëheni të devotshëm”.*

Pra, agjërimi ka qenë farz (obligim) edhe për ummetet e mëparshme, si për hebrenjtë dhe të krishterët, edhe ata kanë agjërim sikurse ne, mirëpo ata agjërojnë ndryshe, vetëm duke mos ngrënë yndyrë etj.

Qëllimin pse agjërojmë e gjejmë te fjala e Zotit: *“...me qëllim që të bëheni të devotshëm”.* Pra, përmes agjërimit njeriu e pastron zemrën dhe shpirtin e vet. Njeriu që agjëron e kupton se njeriu nuk e ka vetëm trupin që duhet ta ushqejë, porse e ka edhe shpirtin. Ushqimi i shpirtit janë ibadetet, si: namazi, agjërimi, zekati, haxhi, leximi i Kur’anit etj.

All-llahu xh. sh. si dhe Muhammedi a.s. kanë premtuar shpërblime shumë të mëdha për atë musliman apo muslimane që agjëron muajin Ramazan.

Me agjërim është i obliguar: njeriu i moshës madhore, i mençuri, i shëndoshi dhe ai që ka mundësi të agjërojë. Nuk duhet të agjërojë: i sëmuri rëndë, gruaja me menstruacion, plaku ose plaka e pamundur...

Agjërimin e prish: me qëllim të hash ose të pish diçka dhe të kesh marrëdhënie intime. Ky person ngarkohet me agjërimin e 61 ditëve si dënim për prishjen e një dite të Ramazanit me qëllim dhe pa kurrfarë arsyeje.

Agjërimi nuk prishet kur: njeriu ha ose pi diçka nga harresa, kur zgjohet nga gjumi xhunub, kur lahet ose bën banjo (nëse gjatë kësaj nuk i hy ujë përmes gojës apo hundës), nëse i heq erë lules, nëse dhuron gjak.

Në Ramazan, në kohën e jacisë, është sunnet edhe falja e namazit të teravisë, i cili përbëhet nga 20 rekate.

Detyrë shtëpie:

1. Çka do të thotë agjërim?
2. Cili ajet kur’anor na tregon se agjërimi është farz?
3. Pse agjërojmë ne muslimanët?
4. Kush është i obliguar të agjërojë?
5. Çka e prish agjërimin?
6. Kur nuk prishet agjërimi?

Mësimi 29

RAMAZANI DHE AGJËRIMI

Husejni: Tungjatjeta, Gazmend!

Gazmendi: Tungjatjeta, Husejn. Urdhëro të hamë bukë!

Husejni: Të hamë bukë në Ramazan?! Jo, Gazmend. Unë agjëroj.

Gazmendi: Agjëron?! Çka do të thotë agjërim?

Husejni: Agjërim do të thotë të mos hash, të mos pish dhe të mos i bësh punët që e prishin agjërimin. Agjërimi fillon qysh nga agimi e deri kur të perëndojë dielli.

Gazmendi: Kush duhet të agjërojë?

Husejni: Duhet të agjërojë çdo musliman i mençur që e ka arritur moshën e pjekurisë, që ka fuqi për të agjëruar dhe nuk ka kurrfarë pengesash.

Gazmendi: Në cilin muaj duhet të agjërohet?

Husejni: Agjërimi kryhet në muajin e nëntë të Ramazanit, pra një muaj i plotë.

Gazmendi: Po mirë, pse duhet të agjërojmë?

Husejni: Duhet të agjërojmë, sepse kështu na urdhëron All-llahu xh.sh. Kurse All-llahu nuk na ngarkon me një punë që ne nuk mund ta bëjmë ose që është në dëmin tonë. All-llahu na do neve, prandaj edhe na mëson se si duhet të veprojmë në këtë jetë.

Gazmendi: Mirë, Husejn. Po ti je i vogël ndërsa unë kam parë shumë fëmijë të vegjël si ne që nuk agjërojnë.

Husejni: Po, ashtu është. Por unë dua të mësohem të agjëroj qysh si i vogël.

Gazmendi: Mrekulli! Atëherë prej nesër edhe unë do të agjëroj sikurse ti.

Husejni: Të lumtë, Zoti të ndihmoftë!



Detyrë shtëpie:

1. Çka do të thotë agjërimi?
2. Kush duhet të agjërojë?
3. Në cilin muaj duhet të agjërohet?
4. Pse duhet të agjërojmë?

Mësimi 30

ZEKATI

Zekati është shtylla apo detyra e katërt kryesore e muslimanit.

Fjala “zekat” nënkupton një pjesë të pasurisë të cilën pasaniku musliman një herë në vit ia jep të varfrit musliman me qëllim ibadeti.

Njeriu quhet pasanik nëse përveç nevojave elementare (ushqim, veshje dhe banim) të vetat dhe të familjes së vet i tepron pasuria për 86 gr. ar ose 640 gr. argjend ose sa kushtojnë këto të dyja.

Zekati jepet pasi të jetë mbushur një vit. Kështu, nëse një musliman, përveç nevojave elementare, ka pasuri më tepër se 86 gr. ar ose sa kushton kjo në para, pasi të mbushet një vit, ai duhet të paguajë zekat.

Zekat jepet 2.5 % (ose 1/40) nga pasuria e përgjithshme që ka pasaniku.

Zekat jepet për këto lloje të pasurisë: ar, argjend, para, mall tregtie, dhen, dhi, lopë, deve, si dhe për prodhime bujqësore (pemë e perime).

Kujt i takon zekati për ta marrë? Zekati u takon këtyre 8 grupeve të njerëzve: të varfrit, të vobektit të pastrehë, atij që e mbledh zekatin (në shtetin islam), atyre që duhet t'u ngrohet zemra për ta pranuar Islamin, robërve të luftës ose skllëvërve, borxhlinjve (për nevoja elementare), atyre që luftojnë në rrugë të Zotit (për t'i mbrojtur muslimanët) si dhe atyre që kanë mbetur në rrugë dhe s'kanë para me vete.

Kujt nuk i takon ta marrë zekatin? Zekati nuk u takon ta marrin njerëzit që jetojnë në një shtëpi apo në një banesë dhe ushqehen bashkë me dhënësin e zekatit, p.sh.: babait, nënës, gruas, fëmijëve etj.

Muhammedi a.s. ka folur shumë për rëndësinë e zekatit. Në një hadith ai ka thënë: *“Nuk i pakësohet pasuria atij që e jep zekatin. All-llahu ia shton nderin atij që ua fal gabimet të tjerëve. All-llahu e lartëson atë njeri që është modest e kokulur”*.

Detyrë shtëpie:

1. Ç'do të thotë fjala zekat?
2. Kur quhet një njeri pasanik?
3. Sa përqindje paguhet zekati?
4. Kujt i takon zekati për ta marrë?
5. Çfarë ka thënë Muhammedi a.s. për zekatin?



Mësimi 31

HAXHI

Kushti i pestë i fesë islame është shkuarja në haxh, për ata që kanë mundësi.

Haxh quhet vizita e Qabes dhe e vendeve të tjera përreth Mekkes me qëllim ibadeti që bëhet në kohën e kurban bajramit.

Haxhilerët në vendin e quajtur Mikat i veshin ihramet (dy peshqirë të bardhë për burrat, kurse për gratë veshje


normale), pastaj e bëjnë tavaf Qaben shtatë herë, i falin dy rekatë namaz te Mekami Ibrahim, e bëjnë sa'jin (ecje midis kodrinave Safa dhe Merve), pastaj një ditë para bajramit qëndrojnë në luginën Arafat ku falin namaz dhe lutën, në mbrëmje shkojnë në vendin e quajtur Muzdelife ku bëjnë lutje dhe mbledhin 49 gurë të vegjël. Të nesërmen, pra në ditën e bajramit, haxhilerët shkojnë në Mina ku i hedhin 7 gurë te vendi i caktuar që simbolizon gurëzimin e shejtanit, pastaj i presin kurbanat e më pas shkojnë në Mekke ku e kryejnë tavafin farz bashkë me sa'jin. Në ditën e dytë e të tretë të bajramit haxhilerët shkojnë prapë në Mina ku gjuajnë nga 21 gurë. Atë ditë që e lëshojnë haxhilerët Mekken, e kryejnë edhe një tavaf lamtumirës.

Haxhin borxh e ka një herë në jetë, njeriu i cili është i mençur, në pubertet, i shëndoshë, pasanik (zengjin) dhe ta ketë rrugën e lirë.

Muhammedi a.s. ka thënë: *“Ai njeri që e bën haxhin si duhet, kthehet në shtëpi i pastër prej gjynaheve sikur atë ditë që e ka lindur nëna e tij”.*

Detyrë shtëpie:

1. Çka quajmë haxh?
2. Si kryhet haxhi?
3. Kush e ka borxh haxhin?
4. Çka ka thënë Muhammedi a.s. për vlerën e haxhit?



Mësimi 32

BAJRAMI I KURBANIT

Bajrami i Kurbanit është festë fetare e muslimanëve të cilën ne e quajmë edhe “Bajrami i Vogël” ose “Bajrami i Haxhit”. Ky Bajram zgjat katër ditë e bie në muajin e Dhul-Hixhhes duke filluar nga dita e dhjetë e tij.



Në bajramin e kurbanit muslimanët shkojnë herët në xhami ku e falin namazin e sabahut, e dëgjojnë ligjëratën e hoxhës dhe e falin namazin e bajramit, të cilin e kanë obligim (vaxhib) vetëm burrat. Por

edhe gratë mund të marrin pjesë në ligjëratë dhe në namazin e sabahut dhe të bajramit.

Pas namazit të bajramit muslimanët zakonisht shkojnë dhe i vizitojnë varrezat muslimane dhe i luten Zotit për ata që gjenden në varreza. Më pas vijnë dhe bashkë me anëtarët e familjes e hanë ushqimin e bajramit që e ka përgatitur zonja e shtëpisë.

Prej namazit farz të sabahut në ditën e Arafatit (një ditë para bajramit) e deri në namazin e ikindisë së ditës së katërt të bajramit, pra gjithsej 23 namaze, pasi të jepet selam menjëherë lexohet *Tekbiri teshriku*, pra këndohet: **“All-llahu ekberull-llahu ekber. La ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber. All-llahu ekberu ve lil-lahil hamd”**. Nëse dikush harron ta lexojë pas farzit, duhet ta lexojë kurdo që t’i kujtohet.

Zoti i Madhëruar ka urdhëruar që në këtë bajram të pasurit të therin nga një kurban. Prandaj ky bajram quhet edhe “Bajrami i Kurbanit”. “Kurban” do të thotë “kafshë e therur për All-llahun, sakrificë, flijim”.

Me kurbanin, jo vetëm që dëgjohet fjala e Zotit, por edhe u ndihmohet njerëzve të varfër, të cilët ndoshta me muaj të tërë nuk kanë mundur ta shijojnë mishin nëpër sofrat e tyre.

Kurban mund të priten kafshët si: dashi, delja, cjapi, dhija, lopa, kau, bulli, bullica dhe devja. Këto pesë të fundit vlejnë për shtatë persona, kurse katër të parat vetëm për një person.

Mishi i kurbanit është më mirë të ndahet në 3 pjesë: një pjesë ndalet për familjen, një pjesë u ndahet fqinjëve dhe pjesa e tretë u ndahet nevojtarëve, fukarenjve.

Detyrë shtëpie:

1. Ç’është Bajrami i Kurbanit?
2. Çka ka urdhëruar Zoti për këtë bajram?
3. Ç’është kurban dhe cilat kafshë mund të priten për kurban?
4. Pse kjo festë quhet edhe “Bajrami i Haxhit”?
5. Çka quajmë “ihram”?

Mësimi 33

TRI KËSHILLAT E BILBILIT

Një gjuetar kishte kurdisur një kurth dhe e kishte kapur një bilbil. Sapo e mori bilbilin në grusht, bilbili filloi të flasë dhe i tha gjuetarit: “O gjuetar, ti qe sa kohë ke ngrënë dele e qengja. Nuk je ngopur me to dhe do që të ngopesh me mishin tim që nuk bën as tre franga? Të lutem, liromë se do të jap nja tri këshilla të mira për këtë nder. Njërën prej këtyre këshillave do ta them në grushtin tënd, të dytën në çatinë karshi dhe të tretën në drurin pranë”.

Gjuetari u pajtua dhe i tha: “Si urdhëron...”

Bilbili ia dha këshillën e parë: “Mos i beso asaj që nuk bëhet, kushdo që ta thotë atë!”.

Gjuetari, për ta dëgjuar këshillën e dytë, e liroi bilbilin. Ai hipi mbi çati dhe ia tha edhe këshillën e dytë: “Mos u mërzit për gjërat që të kanë kaluar. Mos u dëshpëro për rastin që të ka ikur. Dija vlerën kohës në të cilën jeton. Mos humb kohë duke u penduar...”

Pastaj shtoi: “O gjuetar, në barkun tim kam një inxhi (perlë) që kushton 100 franga. Këto do të kishin mjaftuar për ty dhe për pasardhësit tu. Sa keq, e humbe rastin... Paska qenë kësomet për dikë tjetër... Në botë nuk ka perlë tjetër sikurse kjo”.

Gjuetari filloi të dëshpërohej e të qajë duke thënë: “Ahh! Çfarë bëra unë që të lirova?”

Atëherë bilbili ia ktheu: “More zotëri, pse po qan e mërzitesh? A nuk të këshillova të mos mërzitesh për gjërat që të kanë kaluar e të mos dëshpërohesh për rastin që të ka ikur? Pastaj, a nuk të thashë të mos i besoje asaj që nuk bëhet dot, kushdo që ta thotë? Unë vetë nuk bëj tre franga, e si paska mundësi që në barkun tim të ketë një perlë prej 100 frangash?”

Gjuetari u mbush mend. Iu drejtua bilbilit të mençur që i rrinte karshi dhe sikur po tallej me të: “Mirë, po ç’ishte këshilla jote e tretë? Thuama këtë dhe pastaj ik..!”

Bilbili e tejkaloi murin dhe u ul në dru. Me një gjuhë tallëse iu drejtua gjuetarit: “Pasha Zotin, ti i mbajte dy këshillat e para dhe të mbeti e treta pa e mbajtur? Lëre këtë punë, mos ma merr kohën...” – dhe fluturoi lart e lart i lirë.



Gjuetari mbeti i shtangur nga kjo që i ndodhi.

Detyrë shtëpie:

Shkruaje këtë tekst ashtu siç është!

Mësimi 34

MORALI ISLAM

Feja islame është një sistem i plotë jete dhe ajo ka ardhur për ta rregulluar jetën e njeriut në këtë botë. Nëpërmjet fesë njeriu mund ta gjejë lumturinë në këtë jetë si dhe kënaqësinë në botën tjetër.

Krahas besimit dhe ibadeteve, morali është fusha më me rëndësi për arritjen e lumturisë.

Moral do të thotë: Norma e rregulla që e zbukurojnë jetën e jashtme dhe të brendshme të njeriut. Me fjalë të tjera, moral do të thotë: sjellje e mirë, fjalë e bukur dhe punë e ndershme.

Këto sjellje të mira, fjalë të bukura e punë të ndershme njeriu duhet t'i tregojë: 1. karshi Zotit, 2. karshi njerëzve të tjerë, 3. karshi vetvetes si dhe 4. karshi krijesave të tjera të Zotit.

Muhammedi a.s. thotë: **“Më i miri prej jush është ai që ka moral më të mirë”**.

Në një hadith tjetër ai thotë: **“Njeriun që unë e dua më së shumti dhe i cili në Kijamet do të jetë afër meje, është ai i cili ka moral të mirë”**.

Në mësimet e ardhshme ne do të flasim për normat e moralit si dhe për obligimet që i ka njeriu karshi katër grupeve që i përmendëm më lart.



Detyrë shtëpie:

1. Çfarë është feja islame?
2. Çka do të thotë “moral”?
3. Karshi kujt duhet njeriut të tregojë sjellje të mirë, fjalë të bukura e punë të ndershme?
4. Çfarë ka thënë Muhammedi a.s. për moralin e mirë?

Mësimi 35

DETYRAT TONA NDAJ ZOTIT



Zoti ose All-llahu xh.sh. është Krijuesi ynë dhe i gjithçkaje që ekziston në këtë botë. Sikur mos të ishte Zoti, nuk do të ishim as ne e as kurrgjë tjetër në këtë botë.

Zoti na ka dashur, prandaj edhe na ka krijuar. Sikur të mos na kishte dashur, nuk do të na kishte krijuar.

Zoti neve na ka krijuar në formën më të mirë e më të bukur, na ndihmon neve vazhdimisht, na jep mundësinë të ushqehemi me atë që e ka krijuar Ai, na mundëson të thithim ajrin e Tij, na ka mundësuar të jetojmë në tokën e Tij dhe t'i shfrytëzojmë të gjitha të mirat e saj, tekefundit na ka mundësuar të jetojmë brenda këtij trupi me të gjitha gjymtyrët që i kemi.

Për këtë arsye, ne i kemi borxh Zotit. Disa borxhe apo detyra tonat karshi Zotit janë:

- Të besojmë se Ai ekziston dhe se është vetëm Një Zot,
- Ta duam Atë me gjithë zemër gjatë gjithë jetës sonë,
- Vetëm Atij t'i lutemi dhe vetëm prej Tij të kërkojmë ndihmë,
- Ndjaj Tij gjithnjë të sillemi me edukatë dhe emrin e Tij ta përmendim me nderim, duke thënë së paku “xhel-le shanuhu” (i madhëruar qoftë Ai!),
- T'i kryejmë urdhrat (farzet) e Tij dhe t'u largohemi ndalimeve (haramëve) që i ka caktuar Ai,
- Ta falënderojmë vazhdimisht Zotin për krejt të mirat që na ka dhënë.

Detyrë shtëpie:

1. Kush është Zoti ose All-llahu xh.sh.?
2. Pse na ka krijuar Zoti neve?
3. Çfarë ka bërë Zoti për ne?
4. Cilat janë disa prej detyrave tona karshi Zotit?

Mësimi 36

DETYRAT TONA NDAJ PRINDËRVE

Menjëherë pas detyrave tona ndaj Zotit vijnë detyrat ndaj prindërve, ndaj nënës dhe babait.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:
 “Zoti yt ka urdhëruar, që të mos
 adhuronit askënd tjetër përveç Atij
 dhe, që të silleni mirë me
 prindërit...” (Isra: 23).



Dikush e pyeti Muhammedin a.s.:
 “O i Dërguar i Zotit, kujt ia kam
 borxh më shumë shoqërimin dhe
 mirësjelljen?”. Ai u përgjigj:
 “Nënës”. “Po, pastaj?” – pyeti ky.
 Ai tha: “Nënës”. “Po, pastaj?” –
 vazhdoi ky. “Nënës” – u përgjigj
 ai. “Po, pastaj?” – insistoi ky.
 “Babait” – u përgjigj Muhammedi
 a.s.

Po ashtu dikush e pyeti Muhammedin a.s.: “Cila është puna më e dashur për All-llahun?”.
 Ai u përgjigj: “Falja e namazit në kohën e vet, respektimi i nënës dhe babait...”

All-llahu xh.sh. në vazhdimin e ajetit të mësipërm thotë: “Nëse njëri prej tyre ose të dy
 arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i qorto, por drejtoju atyre me fjalë
 respekti” (Isra:23).

Dikush erdhi te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti: “A më ka mbet akoma ndonjë detyrë ndaj
 prindërve që kanë ndërruar jetë?”. Muhammedi a.s. u përgjigj: “Po, të bësh lutje (dua)
 për ta, të kërkosh prej All-llahut t’ua falë gjynahet, ta çosh në vend testamentin e tyre, t’i
 vizitosh dhe t’i nderosh shokët e tyre”.

Detyrë shtëpie:

1. Çfarë thotë All-llahu xh.sh. në suren Isra, ajeti 23? (Komplet ajeti)
2. Cila është puna më e dashur për All-llahun xh.sh.?
3. Çfarë thotë Muhammedi a.s. për detyrat ndaj prindërve që kanë ndërruar jetë?

Mësimi 37

DJALOSHI DHE DRURI I MOLLËS

Na ishte njëherë një dru i madh molle. Një fëmijë e kishte qejf të vinte për çdo ditë e të lozte rreth e rrotull tij. Ai ngjitej në maje të drurit, hante molla dhe pastaj e merrte një sy gjumë nën hijen e tij. Kaloi një kohë e gjatë, fëmija i vogël u rrit dhe nuk vinte më për çdo ditë të lozte përreth pemës.

Një ditë, djaloshi u kthye te pema, mirëpo dukej i zyrtë. “Eja dhe luaj me mua”, iu lut pema djalit. “Nuk jam më fëmijë, unë nuk luaj më përreth drunjve, unë dua lodra, mirëpo nuk kam para t’i blej”. “Më vjen keq, ama unë para nuk kam. Mund t’i mbledhësh të gjitha mollët e mia, t’i shesësh dhe të bësh paratë”, i tha druri i mollës. Djalosht iu bë qejfi shumë. I rrëmbeu të gjitha kokrrat e mollëve dhe iku i lumtur. Mirëpo ai nuk u kthye më pasi i kishte mbledhur mollët. Druri u zyrtua shumë.

Një ditë djaloshi, i cili tanimë ishte bërë burrë, u kthye sërish për çka pema u gazmua së tepërmi. “Eja dhe luaj me mua”, i tha pema. “Nuk kam kohë të luaj. Më duhet të punoj për familjen. Na duhet një shtëpi për strehim. A mund të më ndihmosh?”, i tha ky. “Më vjen keq, ama unë nuk kam shtëpi. Ti mund t’i presësh degët e mia dhe të ndërtosh një shtëpi”, i tha druri njeriut. Ky ia preu të gjitha degët dhe iku i lumtur. Druri u gëzua kur e pa atë të lumtur, mirëpo njeriu nuk u kthye më tek ai. Druri sërish mbeti i vetmuar dhe i zyrtë.

Një ditë të nxehtë vere, njeriu u kthye prapë, ndërsa druri u gëzua tej mase. “Eja dhe luaj me mua!”, i tha druri. “Po plakem. Dua të shkoj të lundroj me anije për t’u çlodhur. A mund të më japësh një varkë?”, i tha njeriu drurit. “Përdore trungun tim për ta ndërtuar një varkë. Pastaj lundro larg e larg dhe kënaqu”. Kështu njeriu e preu trungun e drurit për ta ndërtuar varkën. Ai shkoi për lundrim dhe nuk u duk më për një kohë të gjatë.

Përfundimisht, njeriu u kthye sërish te druri i mollës pas shumë vitesh të kaluara. „Më vjen keq, biri im. Nuk kam më asgjë për ty, nuk kam më mollë të të jap“, i tha druri. „S’ka gjë, edhe unë nuk kam më dhëmbë për të kafshuar“, iu përgjigj njeriu. „Nuk kam më trung të ngjitesh në të“, i tha druri. Njeriu i tha: „Jam shumë plak për atë punë, s’ngjitem dot“. „Vërtet nuk mund të të jap asgjë. E vetmja gjë që më ka ngelur janë rrënjët e mia që po më vdesin“, i tha druri i përlotur. „Tani nuk kam nevojë për diçka më tepër sesa një vend për t’u ulur. Jam lodhur fort pas kaq e kaq vitesh“, iu përgjigj njeriu. “O Zot, rrënjët e një druri të moçëm janë vendi më i mirë për t’u mbështetur në to e të pushosh. Eja, ulu pranë meje dhe pusho”, i tha druri. Njeriu erdhi, u ul pranë tij, ndërsa druri ishte shumë i lumtur dhe qeshej me lot.

Ky rrëfim vlen për çdokënd. Druri është sikurse prindërit tanë. Kur jemi të vegjël, duam të luajmë me mamën dhe babin. Kur rritemi, i braktisim ata; vijmë te ta vetëm kur na duhet diçka ose kur jemi në belë. Sido që të jetë, prindërit janë gjithnjë aty dhe do të na japin gjithçka që munden, vetëm e vetëm të na bëjnë të lumtur.

Juve mund t’ju duket se djaloshi ishte shumë i vrazhdë ndaj drurit. Po. Edhe ne të gjithë jemi të tillë ndaj prindërve tanë. Mbështetemi tek ata, mirëpo nuk e çmojmë atë që ata e bëjnë për ne.

“O Zot, na fal për gabimet tona ndaj prindërve dhe na udhëzo në rrugë të mbarë!”

Mësimi 38

DETYRAT TONA NDAJ NJERËZVE TË TJERË

Zoti në Kur'an thotë: *“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi prej jush është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)..”* (Kur'ani, 49:13)

Pra, ne të gjithë jemi të një babai dhe një nëne, e pastaj jemi ndarë në kombe, fe, raca e kultura të ndryshme. Asnjëra prej këtyre nuk është ndonjë privilegj, përpos devotshmërisë.

Ne duhet ta respektojmë secilin njeri, të sillemi me drejtësi, t'i ndihmojmë e t'u flasim vetëm të vërtetën, pa marrë parasysh se cilës fe, cilit komb, cilës racë i takojnë.

Muslimani ndaj vëllait të vet musliman ka disa detyra shtesë. Muhammedi a.s. thotë se muslimani ndaj muslimanit ka 5 detyra: 1. Kur të takohet me të, t'i japë selam, 2. Kur ta ftojë në takim, t'i përgjigjet, 3. Kur të teshtijë e të thotë “el-hamdu lil-lah” (Falënderimi i takon All-llahut) – ky t'i përgjigjet me “jerhamukallah” (All-llahu të mëshiroftë!), 4. Kur të sëmuret, ta vizitojë dhe 5. Kur të vdesë të marrë pjesë në namazin e xhenazes dhe në varrim”.



Muslimani ka edhe detyra të tjera ndaj muslimanit, si p.sh.: t'ia falë gabimet, t'ia mbulojë të metat, të mos e përqeshë, t'ia ruajë amanetin, të mos hidhërohet me të, t'i japë e të pranojë prej tij dhurata, gjithnjë të flasë fjalë të bukura e të ëmbla me të, t'i ndihmojë kur ka nevojë, t'ia dojë atij atë që ia do edhe vetvetes dhe të mos ia dojë atij atë që nuk ia do vetvetes...

Detyrë shtëpie:

1. Çka thotë Zoti në Kur'an lidhur me krijimin e njeriut?
2. Çka duhet të bëjmë ne me secilin njeri?
3. Sipas një hadithi të Muhammedit a.s., sa detyra ka muslimani ndaj muslimanit?
4. Cilat janë disa detyra tjera të muslimanit ndaj muslimanit?

Mësimi 39

JETA

Një djalë dhe babai i tij ishin duke ecur nëpër një mal. Papritmas, djali u rrëzua dhe nga lëndimi që mori bërtiti: “Aaahhhh!”. Për habi të tij, diku thellë në mal dëgjoi përsëritjen e asaj që e tha ky: “Aaahhhh!”.

Nga kureshtja bërtiti: “Kush je ti?”. Mori përgjigjen: “Kush je ti?”.

I nervozuar nga përgjigja ai piskati: “I poshtër!”. Mirëpo përgjigjen e mori: “I poshtër!”.

E shikoi babanë dhe e pyeti: “Çka po ndodh?”.

Babai buzëqeshi dhe i tha: “Shiko tani bir, se ç’do të ndodhë!”.

Atëherë babai i bërtiti malit: “Unë të dua ty”.

Zëri iu përgjigj: “Unë të dua ty”.

Sërish babai bërtiti: “Ti je një kampion”.

Zëri iu përgjigj: “Ti je një kampion”.

Djali u habit fare mirëpo nuk e kuptoi dot se si bëhej kjo kështu. Atëherë babai ia sqaroi: “Njerëzit këtë e quajnë ‘JEHONË’, mirëpo kjo në të vërtetë është ‘JETË’. Ajo ta kthen prapë krejt atë që ti e bën ose e thua. Jeta jonë thjesht është reflektim i veprimeve tona. Nëse do më shumë dashuri në botë, krijo më shumë dashuri në zemrën tënde. Nëse do më shumë aftësi në ekipin tënd, rrite aftësinë tënde. Kjo lidhje vlen për gjithçka dhe në të gjitha aspektet e jetës: Jeta të kthen prapë gjithçka që ti i ke dhënë asaj”.

JETA NUK ËSHTË RASTËSI... AJO ËSHTË REFLEKTIMI YT!

Detyrë shtëpie:

Shkruaje këtë tregim ashtu siç është.



Mësimi 40

NE DHE KRIJESAT TJERA TË ZOTIT

Nëse shikojmë rreth vetes me vëmendje, do të vërejmë se All-lahu xh.sh. është Ai i cili e ka krijuar gjithësinë, planetët, njerëzit, kafshët, bimët, insektet etj. Të gjitha këto Ai i ka krijuar me përpikëri dhe me një bukuri të mahnitshme për njeriun.

Zoti neve si njerëz na ka dhuruar mendtë për ta organizuar mirë jetën tonë në këtë botë dhe për të qenë përgjegjës për sendet që na rrethojnë. Zoti në Kur'an (2:30) thotë se njeriu është "halif" (mëkëmbës) i Zotit në tokë, pra ai është përgjegjës për vetveten, natyrën, kafshët etj.

Ne si njerëz e kemi detyrë ta ruajmë natyrën me të gjitha bukuritë që ka si dhe të kujdesemi për jetën e gjallesave të tjera. Lidhur me këtë Zoti flet në shumë vende në Kur'an.

Pejgamberi a.s. ka pasur shumë kujdes si për natyrën dhe mjedisin, ashtu edhe për kafshët e gjallesat e tjera. Ai i qortonte njerëzit që i keqtrajtonin kafshët, i mësonte si të sillen mirë me to dhe u thoshte se për këtë sjellje të mirë ata do ta fitojnë Xhennetin.

Në një hadith thuhet: "Një njeri ishte etur shumë nga rruga e gjatë. E gjen një pus dhe zbret poshtë për të pirë ujë. Kur del lart, e sheh një qen që e lëpinte dheun. Ky tha me vetvete: "Këtë qen e paska gjetur ajo që më pati gjetur mua". Zbriti prapë në pus, e mbushi këpucën e vet me ujë dhe ia dha qenit të pinte. Zoti ia njohu atij këtë punë të mirë dhe ia fali mëkatet..."



Në një hadith tjetër Muhammedi

a.s. ka thënë: "Secili musliman që mbjell një filiz ose një bimë dhe pastaj prej saj hanë zogjtë, njerëzit ose kafshët, atij do t'i quhet sikur të ketë dhënë lëmoshë (sadaka)".

Kurse për kujdesin ndaj bimëve e pemëve ai ka thënë: "Nëse dikush prej jush në ditën e fundit në këtë botë në dorë ka një filiz peme për ta mbjellë dhe ka mundësi ta bëjë këtë, gjithsesi le ta mbjellë atë filiz."

Detyrë shtëpie:

1. Si e ka krijuar Zoti gjithësinë?
2. Sipas Kur'anit, çfarë është njeriu në tokë?
3. Çfarë thotë Muhammedi a.s. për njeriun që i jep ujë qenit të etur?
4. Çfarë thotë Muhammedi a.s. për mbjelljen e filizave ose bimëve?